



РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ТРУД И СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА

REPUBLIC OF MACEDONIA
MINISTRY OF LABOR AND SOCIAL POLICY

Strategji nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen teknike dhe financiare
të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Zyra në Shkup

Ministria për punë dhe politikë sociale
Z-nja Sofija Spasovska
Z-nja Irena Todorovska
Z-nja Lidija Shterjov

Sekretariati i përgjithshëm
Z-nja Vesna Vasileva

Sekretariati për çështje evropiane
Z-nja Aleksandra Vukovic
Z-nja Nena Nenovska

Ministria për punë të brendshme
Z-nja Liljana Jakovčevska
Z-nja Zhaklina Prosaroska

Ministria e drejtësisë
Z-nja Tanja Kikerekova
Z-nja Marijana Atanasoska

Ministria e shëndetësisë
D-r Suzana Manevska
Prof. d-r Marija Raleva

Ministria e arsimit dhe shkencës
z. George Nikollov
Z-nja Nada Stoimenova

Rrjeti OJQ
Z-nja Mila Carovska
Z-nja Elena Dimushevska

Programi i përbashkët për organizatat e KB-ve,
“Përforcimi i kapaciteteve nacionale për parandalimin e dhunës në familje”

Z-nja Jasmina Trajkovska
z. Nehat Ramadani
Z-nja Jelena Krasic
Z-nja Biljana Nastovska
Z-nja Dimitrinka Jordanova Peshevska
Z-nja Sherife Ismaili Kasapi
Z-nja Makedonka Trajkovska
Z-nja Ivona Paunović
Z-nja Olimpija Grozdanovska

Konsulent nacional
Doc d-r Stojanka Mirceva

Përkthyes
Jehona Zhuta-Vrenezi

P È R M B A J T J A

Mirënjohje v
Lista e shkurtesave..... vi
Fjalorth i termeve dhe definicionevevii

Hyrje..... 1
Metodologjia e përpilimit të Strategjisë nacionale..... 3

Pjesa e parë.....5
1.1. Analizë e gjendjes 5
1.1.1. Rishikim i hulumtimeve të zbatuara në vend rreth problematikës së dhunës në familje..... 5
1.1.2.Të dhëna statistikore për rastet e raportuara të dhunës në familje pranë organeve kompetente..... 9
1.1.3. Korniza juridike për trajtim të çështjes së dhunës në familje 14
1.1.3.1. Mbrojtja penalo-juridike..... 14
1.1.3.2. Pozita e viktimës së dhunës në familje sipas Ligjit të ri për procedurë penale 15
1.1.3.3. Masa për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje në procedurën qytetare 16
1.1.4. Rezultate nga Strategjia nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011 17
1.1.4.1. Aktivitetet e zbatuara 17

Pjesa e dytë.....25
2.1. Vizioni..... 25
2.2. Misioni 25
2.3. Karakteristikat kryesore inovative të Strategjisë 2012-2015..... 25
2.4. Parimet kryesore 26
2.4.1. Përgjegjësi 26
2.4.2. Partneritet..... 26
2.4.3.Të vepruarit me viktimat sipas të drejtave dhe lirive të njeriut..... 26
2.4.4. Jodiskriminimi..... 26
2.4.5. Transparencë 27
2.4.6. Efikasitet dhe qëndrueshmëri..... 27
2.5. Rreziqet 27

Pjesa e tretë – Qëllimet strategjike29
3.1. Qëllimi kryesor strategjik..... 29
3.1.1. FUSHA STRATEGJIKE - Parandalimi 29
3.1.2. FUSHA STRATEGJIKE – Mbrojtje, ndihmë dhe përkrahje të viktimave 31
3.1.3. FUSHA STRATEGJIKE – Përndjekja e autorëve 34
3.1.4. FUSHA STRATEGJIKE – Bashkëpunim mes sektorëve dhe rritje të kapaciteteve dhe shërbimeve të specializuara 35
3.1.5. FUSHA STRATEGJIKE – Implementim, monitorim dhe vlerësim..... 36

Pjesa e katërt37
Implikimet financiare 37
Aneksi I: Grupi punues për përgatitjen e Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015..... 38
Aneksi II..... 39
Aneksi III: Struktura dhe detyrat e organit koordinativ nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje 41
Aneksi IV: Plan për zbatim 44

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје
364.63-027.553-21(497.7)“2012/15”

НАЦИОНАЛНА стратегија за спречување и заштита од семејно насилство : 2012-2015 / [автори Софија Спасовска . и др.]. - Скопје : Министерство за труд и социјална политика ; =Skopje : Ministry of labor and social policy, 2012. - 57, 54 стр. : табели, граф. прикази ; 21 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Strategji nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje : 2012-2015. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4595-18-2
а) Семејно насилство – Стратегија за спречување – Македонија – 2012-2015
COBISS.MK-ID 92574218

Shprehje falënderimi

Mirënjohje

Të nderuar,

Dhuna në familje është vepër penale. Secili prej nesh ka të drejtë të jetojë jetën në mënyrë të sigurtë dhe sipas nevojave të veta. Dhuna në shtëpi pamundëson sogurinë dhe qetësinë, prek fëmijët, gratë, personat e moshuar dhe anëtarët e tjerë të familjes. Shumë njerëz akoma vuajnë në fshehtësi, në padijeni për të drejtat e tyre dhe ndihmën që mund t'u ofrohet nga institucionet relevante.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë punon me përkushtim në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke konsideruar familjen si qelizë të vetme të shoqërisë në përgjithësi. Në vitin 2008, vendi ynë miratoi Strategjinë e parë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje, e cila u zbatua me sukses në periudhën 2008-2011. Fokus i kësaj Strategjie ishte ngritja e vetëdijes së publikut, përmirësimi i shërbimeve dhe koordinimi mes institucioneve, me çka viktimat do të fitojnë mbrojtje adekuate kudo në territorin e Republikës së Maqedonisë. Zbatimi i Strategjisë u ndihmua nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup dhe nga agjensionet e Kombeve të Bashkuara. Progresi i avansimit të mbrojtjes së drejtave të njeriut u shënuar edhe në Raportin e Bashkimit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2011.

Hulumtimi i parë nacional dëshmoi që institucionet duhet edhe më tej të përqëndrohen në përmirësimin e mbrojtjes së viktimave, në përmirësimin e koordinimit, dhe në veçanti në ngritjen e vetëdijes së publikut.

Duke u nisur nga kjo, përmes një pune të përbashkët dhe përmes përkushtimit të organeve shtetërore, sektorit civil dhe institucioneve ndërkombëtare, u shfaq edhe nevoja për të vazhduar më tej me Strategjinë për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015.

Dëshiroj të faleminderoj të gjitha institucionet, organizatat civile dhe agjensitë e Kombeve të Bashkuara për përkrahje në përpilimin e dokumentit të ri strategjik. Ky dokument na jep udhëzime si të ngrisim vetëdijen e publikut për dhunën në familje, si të përmirësojmë kualitetin e shërbimeve të dedikuara për viktimat, avansimin e koordinimit mes institucioneve dhe standardizimin e shërbimeve.

Në fund, unë besoj në sistemin e themeluar me sukses dhe ju ftoj të gjithëve që t'i kryejmë obligimet tona ndaj viktimave dhe të mos pranojmë e të mos tolerojmë dhunën në familje, të denoncojmë dhunën në familje dhe së bashku, përmes një qasjeje të koordinuar të të gjitha plaëve të përfshira, të ofrojmë përkrahje adekuate.

Me respekt,

Spiro Ristovski

Ministër për punë dhe politikë sociale

Lista e shkurtesave

MPPS	Ministria për punë dhe politikë sociale
MPB	Ministria për punë të brendshme
MSH	Ministria e shëndetësisë
MASH	Ministria e arsimit dhe shkencës
MD	Ministria e drejtësisë
LF	Ligji për familje
LPP	Ligji për procedurë penale
KP	Kodi penal
LPP i ri	Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 10/2010)
OJQ	Oganizata joqeveritare
QPS	Qendra për punë sociale
KE	Këshilli i Evropës

Fjalorth i termeve dhe definicioneve

Dhuna në familje	Me termin dhunë në familje nënkuptojmë maltretim, ofendim të ashpër, kërcënim të sigurisë, lëndim trupor, dhunë në baza gjinore apo lloj tjetër të dhunës psikike apo fizike e cila shkakton ndjenjë pasigurie, ndjenjë rreziku apo frike ndaj partnerit bashkëshortor, ndaj prindërve apo fëmijëve apo personave të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore apo në një amvisëri të përbashkët, si dhe ndaj partnerit të mëparshëm martesor apo ndaj personave me të cilët kanë fëmijë apo janë në marrëdhënie të afërta personale (neni 122, alinea 21 nga KP i RM-së)
Viktimë e një vepre penale	Çdo person që ka vuajtur dëm, përfshirë lëndim fizik apo mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale apo ndonjë lëndim tjetër ose shkelje të të drejtave dhe interesave të tij/saj si pasojë e një vepre penale (neni 21, pika 4, LPP)
Viktimë e dhunës në familje	Mund të jetë partneri bashkëshortor, prindërit apo fëmijët ose persona të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore ose në një amvisëri të përbashkët, si dhe partnerë të mëparshëm martesor apo persona me të cilët kanë fëmijë apo janë në marrëdhënie të afërta personale, motra dhe vëllezër, gjysmë-motra e gjysmë-vëllezër, anëtarë më të moshuar të familjes apo të amvisërisë së përbashkët, pa marr parasysh përkatësinë gjinore apo moshën (neni 94-v nga Ligji për familje).
Fëmijë viktimë e dhunës	Gjendje rreziku për fëmijë të moshës deri në 14 vjeç. Viktimë e dhunës janë edhe personat jomadhör në rrezik që janë më të rinj apo më të vjetër, deri në moshën 18 vjeçare (neni 12 nga Ligji për drejtësi për personat jomadhör)
Marrëdhënie të afërta personale	Marrëdhënie të afërta mes dy personave të gjinive të kundërta që janë apo kanë qenë në marrëdhënie partneriteti por që nuk jetojnë në bashkësi jashtëmartesore (neni 96-6 nga Ligji për familje)
Familje	- Sipas nenit 25 të Kodit penal, ky term nënkupton partnerin martesor, partnerin jashtëmartesor, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat dhe të afërmit e tjerë me të cilët një person jeton në një bashkësi familjare - Sipas nenit 2 të Ligjit për familje është bashkësi e prindërve dhe fëmijëve dhe të afërmve të tjerë, nëse jetojnë në një amvisëri të përbashkët - Sipas nenit 13, alinea 3 e Ligjit për mbrojtje sociale ky term nënkupton një person të vetëm apo një bashkësi mes një burri e një gruaje, të prindërve dhe fëmijëve e të afërmve të tjerë që jetojnë me ata dhe që sipas Ligjit për familje, dy bashkëshortët janë të obliguar të kujdesen për ta
Diskriminim	Çdo dallim apo veprim jo i barabartë i paarsyetuar nga aspekti juridik apo faktik, i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, gjegjësisht, çdo lëshim (përgjashtim, kufizim apo dhënie e përparësisë) ndaj personave apo grupeve që bazohet në përkatësinë e tyre gjinore, racore, apo në ngjyrën e tyre të lëkurës, në të qenurit pjesë e një grupi të marginalizuar, në përkatësinë e tyre etnike, në gjuhën e tyre, shtetësinë, prejardhjen sociale, përkatësinë fetare apo besimin, arsimin, bindjen politike, statusin personal apo shoqëror, pengesat mendore apo fizike, moshën, gjendjen familjare apo martesore, statusin pronësor, gjendjen shëndetësore, apo në çfarëdo baze tjetër (neni 5, pika 3 nga Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi)
Masa për mbrojtje nga dhuna në familje	Obligimi për të ndërmarrë masa për mbrojtje u takon QPS-ve gjithnjë kur janë në dijeni që ndaj ndonjë personi është ushtruar dhunë brenda familjes
Masa të përkohshme për mbrojtje	I shqipton gjyqi në kërkesë të QPS-së apo në kërkesë të viktimës

Hyrje

Dhuna në familje është një fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Të dhënat krahasuese dhe empirike për dhunën në familje shkojnë në favor të pikëpamjes që familja, si bashkësi themelore shoqërore dhe si burim i mbështetjes emocionale, sociale e materiale për anëtarët e saj, shpesh herë mund të shndërrohet në një ambient të dhunshëm ku lëndohen anëtarët e saj dhe shkelen rëndë të drejtat e tyre të njeriut.

Stereotipi që dhuna në familje është vepër e vogël triviale, inherente për çdo familje, është në mënyrë të drejtpërdrejtë në kundërshtim me të gjitha rezultatet që janë grumbulluar nga hulumtimet mbi viktimat në vend dhe jashtë tij që viktimat e dhunës në familje i nënshtrohen një dhune më të madhe për dallim nga viktimat e ndonjë krimi tjetër të dhunshëm¹. Ekzistojnë shumë debate dhe janë zbatuar shumë hulumtime për të vërtetuar arsyet e paraqitjes së dhunës në familje. Dhuna në familje nuk mund të ndërlidhet vetëm me faktorë shoqëror apo vetëm me faktorë psikologjik. Të qenurit pjesë e një klasi, të një grupi etnik, fetar, një statusi social, përdorimi i alkoolit apo lëndëve narkotike, përvojat e dhunshme në fëmijëri të viktimës apo të autorit të dhunës nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë si shkak për dhunën në familje. Të gjithë këta faktorë, në kontekstin konkret shoqëror, mund të kontribuojnë në krijimin dhe praktikimin e raporteve të dhunshme në familje. Nuk ekziton ndonjë sqarim i thjeshtë për arsyet e dhunës në familje. Madje, nuk mund as të veçohet ndonjë grup specifik në shoqëri për të cilin, me argumente, mund të themi që krijon problemin. Përkundrazi, fenomeni i dhunës në familje është i pranishëm në të gjitha segmentet e shoqërisë, pa përjashtime.

Sjellja në familje bazohet në rolet tradicionale që barten nga një gjeneratë në tjetrën. Në thelbin e sjelljes së dhunshme në familje qëndrojnë raportet historikisht jo të barabarta si rezultat i botkuptimeve rreth fuqisë të burrit dhe gruas², dhe, fuqia është në funksion të realizimit të kontrollit në familje dhe mbi anëtarët e saj përmes krijimit të raporteve të dhunshme. Në një raport të tillë të dhunshëm në familje, shpesh herë viktimat janë anëtarët e saj më të ndjeshëm, gratë, fëmijët dhe personat e moshuar.

Shoqëria në Maqedoni karakterizohet me një strukturë patriarkle që në mënyrë dominante përcakton raportet jo të barabarta të fuqisë dhe pushtetit mes burrit dhe gruas. Rendi tradicional gjinor i roleve të meshkujve dhe femrave, roli dominues i burrit, në njërin anë, dhe pozita inferiore e gruas, në anën tjetër, si dhe perceptimi shoqëror për legjitimitetin e pushtetit të burrit përcakton pozitën e gruas në familje dhe në jetën familjare. Pranimi historik i dhunës në familje në shoqërinë e Maqedonisë përcaktohet nga vlerat sociale, ekonomike, politike, morale dhe nga zakonet.

Analiza e dukurisë së dhunës në familje na shpie drejt një konkludimi të përgjithshëm, që ky lloj dhune nuk paraqet veprim të izoluar, as për nga lloji i dhunës, e as për nga intensiteti e

1 Shih më gjerësisht, Davis, R. (1998) , Domestic Violence: Facts and Fallacies, Westport: Praeger Publishers, ST.Çaçeva, V., Frishçiq, J., Mishev, C., (2007), Jetw nw hije, ESE.Shkup.

2 Shih më gjerësisht, Komiteti për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, Këshilli i Evropës, Asamblea Parlamentare (2002)

dinamika. Përkundrazi, element thelbësor i dhunës në familje është përsëritja e aktit të dhunës, i shoqëruar me rritje të intenzitetit, dinamikës dhe llojeve të dhunës.

Sipas definicioneve të dhunës që më shpesh hasen në dokumentet ndërkombëtare, e këtu bën pjesë edhe dhuna në familje si formë e dhunës, gjithnjë kur ka përdorim të dhunës, pa marr parasysh se kush është ushtruesi i dhunës, bëhet fjalë për shkelje të të drejtave dhe lirive bazë të njeriut. Roli i institucioneve shtetërore është tejet i rëndësishëm, jo vetëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në zbatimin e ligjeve, por edhe në parandalimin e përdorimit të mëtejshëm të dhunës.

Vet termi “dhuna në familje” në shoqërinë tonë filloi turpshëm të deportojë në vitet e fundit të shekullit njëzet. Promovimi i dukurisë së dhunës në familje filloi në vitin 1994, ndërsa aktivitetet e para të sektorit joqeveritar në lidhje me këtë dukuri u orientuan drejt njohjes së këtij fenomeni në shoqëri dhe drejt sigurimit të ndihmës dhe përkrahjes së grave viktime dhe fëmijëve të tyre.

Me ndryshimin e legjislationit nacional, Ligjit për familje dhe Kodit penal në vitin 2004, ku për herë të parë dhuna në familje kategorizohet si krim, problemi i dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë humb karakterin e tij si çështje private e familjes dhe si temë tabu. Ndryshimi i botëkuptimit që dhuna në familje është kryesisht një çështje private, përforcon qëndrimin që dhuna në familje duhet të definohet dhe të shihet jo vetëm si kërcënim për viktimat individuale, por edhe si kërcënim për tërë shoqërinë.

Qëllimi kryesor i Strategjisë për parandalim të dhunës në familje është parandalimi i të gjitha formave të dhunës në familje ndaj çdo viktime, por masat të cilat i parasheh kjo Strategji ofrojnë qasje specifike që merret me nevojat individuale të viktimeve. Duke pasur parasysh që si viktime më të përfaqësuara të dhunës në familje janë gratë, Strategjia ofron një kornizë për masa specifike gjinore që kryesisht përqëndrohen në parandalimin e dhunës dhe në mbrojtjen e nevojave specifike të grave, por njëkohësisht ofron edhe një sërë masash dhe aktiviteteve që mbulojnë edhe viktimat tjera.

Strategjia nacionale për parandalim të dhunës në familje 2012-2015 ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv për parandalim të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë. Përpilimi i këtij dokumenti strategjik në një masë të gjerë mbështetet në Strategjinë për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011 dhe paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të qeverisë së Republikës së Maqedonisë për një zgjidhje funksionale dhe efektive për dhunën në familje. Strategjia nacionale gjithashtu është vënë në pajtueshmëri me zotimet dhe obligimet që Qeveria ka marr përsipër si përpjekje për të çrrënjësuar dhunën në familje. Njëkohësisht, Qeveria zotohet edhe ndaj qëllimeve dhe detyrave që janë përfshirë në Strategji, duke patur parasysh, mes tjerash, që zbatimi i tyre i duhur është hap thelbësor për të lidhur politikatat nacionale me politikatat e Unionit Evropian.

Metodologjia e përpilimit të Strategjisë

Strategjia nacionale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje 2012-2015 është përpiluar nga një grup punues i nominuar nga Organi koordinativ nacional për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011 (OKN). Grupi punues përbëhet nga përfaqësues të institucioneve nacionale relevante, të organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare³. Qasja e miratuar për përpilimin e Strategjisë e cila themelohet në pjesëmarrje dhe partneritet vendos një detyrim për të gjithë personat relevant të përfshirë në zbatimin e aktiviteteve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje në nivel nacional.

Strategjia është përpiluar sipas përvojave dhe mësimave të mësuara nga të gjitha institucionet nacionale, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011. Dokumentet nacionale dhe ndërkombëtare për dhunën në familje kanë qenë një burim i rëndësishëm informatash për Strategjinë. Një vëmendje e posaçme iu përkushtua hulumtimeve shkencore për dhunën në familje në nivel ndërkombëtar dhe nacional, që mundësoi një perspektivë të çmuar.

Hapi i parë gjatë përpunimit të Strategjisë ishte analiza e gjendjes momentale në lëminë e parandalimit dhe luftës kundër dhunës në familje, që përfshinte disa aktivitete: shqyrtimin e kornizës rregullatore dhe legjislativës nacionale relevante, përfshirë edhe dokumentet strategjike dhe politike që ndërlidhen me dhunën në familje; Shqyrtimin e gjendjes rreth zbatimit të planeve aksionale vjetore të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011; Shqyrtimin e raporteve vjetore, procesverbaleve nga takimet punuese të OKN-së, vlerësimeve të institucioneve relevante nacionale, si dhe të analizave dhe raporteve të organizatave ndërkombëtare; Vlerësimin e statusit të zbatimit të Strategjisë 2008-2011, përfshirë edhe identifikimin e pengesave dhe sfidave, si dhe anët e fuqishme. Metoda dominante e cila është zbatuar është analiza e dokumenteve në kombinim me metodën kronologjike-tematike dhe diskutimet në grupet e fokusit.

Përfitim i posaçëm nga zbatimi i kësaj metodologjie në punë është zhvillimi i diskutimeve me grupet e fokusit në nivel lokal. Grupet e fokusit kanë karakter shumësektorial, ndërsa pjesëmarrësit u përzgjedhën sipas rolit të tyre në parandalimin dhe sipas përgjegjësisë së tyre në mbrojtjen nga dhuna në familje.

Përpos mungesës së hulumtimeve gjithëpërfshirëse shkencore për dhunën në familje në vend, evidente është edhe mungesa e grumbullimit sistematik të të dhënave statistikore për prevalencën, incidencën dhe llojet e dhunës në familje. Të dhënat e vetme statistikore zyrtare për rastet e dhunës në familje përpunohen nga Ministria e punëve të brendshme dhe nga Ministria për punë dhe politikë sociale. Të dhënat që grumbullojnë dhe analizojnë këto dy ministri të lartëpërmendura japin vetëm numrin e rasteve të paraqitura dhe llojet e shërbimeve të siguruara dhe nuk reflektojnë pasqyrën e vërtetë për përmasat e dhunës në familje dhe për të gjitha llojet

3 Shih Aneksin I- Anëtarë të grupit punues

e dhunës në familje. Si pikënisje, kjo strategji merr të dhënat për dhunën në familje që janë siguruar nga tre hulumtime nacionale të zbatuara në dy vitet e fundit⁴.

Gjatë përpilimit të Strategjisë, mes aktorëve relevantë pati një konsensus të gjerë rreth qëllimeve strategjike dhe masave politike me prioritet që duhet të ndërmerren në periudhën që pason. Janë marr parasysh analizat dhe rekomandimet që janë përfshirë në Raportin e BE-së për progresin e vendit për vitin 2011 në lëminë e luftës kundër dhunës në familje. Ekspertiza teknike e siguruar nga Programi i përbashkët për dhunën në familje i organizatave të Kombeve të Bashkuara, “Përforcimi i kapaciteteve nacionale për parandalimin e dhunës në familje”, ka kontribuar në mënyrë thelbësore drejt zhvillimit të kësaj Strategjie.

Si pika kyçe në përcaktimin e prioritetëve dhe të metodologjisë për përgatitjen e Strategjisë nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015 janë përdor rekomandimet e analizave vendore dhe ndërkombëtare.

Njëkohësisht, gjatë përpilimit të strategjisë u morrën parasysh edhe rekomandimet e Ad Hok – Komitetit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje (CAHVIO), që u formua për përpilimin e tekstit të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje, të cilën Republika e Maqedonisë e firmosi në vitin 2011.

Strategjia mbështetet në dokumente strategjike, në dokumente ndërkombëtare dhe në legjislaturën nacionale⁵:

⁴ „Të keqtrajtuar e të njollosur“- Analizë e gjendjes me keqpërdorimin seksual të fëmijëve, UNICEF, 2010; Prevalenca e keqpërdorimit të personave të moshuar, SZO, 2012 ; Hulumtim nacional për dhunën në familje, UNDP, 2012.

⁵ Shih Aneksin II

Pjesa e parë

1.1 Analizë e gjendjes

Analiza e gjendjes përfshin rishikimin e hulumtimeve të zbatuara në vend që mbulojnë problematikën e dhunës në familje, rishikimin e të dhënave statistikore për rastet e denoncuar të dhunës në familje pranë institucioneve kompetente dhe për aktivitetet e ndërmarra, analizën e kornizës ligjore si dhe rishikimin e aktivteteve të zbatuara të parashikuara në Strategjinë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011.

1.1.1 Rishikim i hulumtimeve të zbatuara në vend rreth problematikës së dhunës në familje

Në periudhën e zbatimit të Strategjisë nacionale 2008-2011, fenomeni i dhunës në familje në vend ishte lëndë e hulumtimeve shkencore të përqëndruara në përcaktimin e përmasave, dinamikës, karakteristikave të dhunës në familje dhe për përcaktimin e nivelit, manifestimeve dhe rrezeve nga dhuna në familje për fëmijët dhe për personat e moshuar. Rezultatet e hulumtimeve të fituara nga hulumtimet e zbatuara nacionale janë me rëndësi për planifikimin adekuat të aktivitetëve strategjike në Strategji, e në veçanti është e nevojshme që të merren parasysh problemet specifike të grupeve të ndjeshme, përfshirë këtu ato të fëmijëve, të personave të moshuar, të grave nga viset rural, të prsonave me invaliditet.

1. „*Hulumtim nacional për dhunën në familje*“ – është zbatuar nga BRIMA-Shkup në vitin 2012, mbështetur nga UNDP në kuadër të Programit të përbashkët të organizatave të Kombeve të Bashkuara “Përforcim i kapaciteteve nacionale për parandalim të dhunës në familje”. Hulumtimi përfshin gra dhe burra në moshë mbi 15 vjeç dhe është zbatuar në një shembull reprezentativ prej 2100 qytetarë. Ky shembull është dizajnuar nga Enti shtetëror i statistikave dhe përfshin 300 njësi hulumtuese të zgjedhura rastësisht, të ndara sipas rajonit dhe mjediseve urbane/rurale. Në secilën prej njësive hulumtuese janë selektuar dhe janë intervistuar nga 7 persona të anketuar. Në hulumtim janë përdor metoda kuantitative për hulumtime nacionale në pajtim me *UNODC-UNECE Manual on Victimization Surveys*. Grumbullimi i të dhënave në teren është bërë brenda periudhës prej 7 marsit deri në 4 prill 2012 përmes bisedës kokë-më-kokë me personat e anketuar.

Qëllim kryesor i hulumtimit është që të sigurojë analizë gjithëpërfshirëse të arsyeve për shfaqjen e dhunës në familje, llojet, incidencën, prevalencën dhe seriozitetin e dhunës. Gjithashtu, rezultatet e hulumtimit mbulojnë edhe njohuritë, të kuptuarit, perceptimet dhe stereotipet tek publiku në lidhje me dhunën në familje, si dhe efektet e fushatave kundër dhunës në familje.

- Sipas rezultateve të hulumtimit,
- Anëtarët meshkuj të amvisërive paraqiten në një përqindje më të madhe si ushtrues të dhunës në familje, më tepër se sa anëtarët femra. Më tej, si autorë të dhunës paraqiten më tepër anëtarë të amvisërisë. Nga ana tjetër, edhe përkaj kufizimeve metodologjike të studimit, gratë janë kryesisht ato që preken nga të gjitha llojet e dhunës në familje.
 - Në ato amvisëri ku shfaqet dhunë, ajo ndodh shpesh herë. Numri i viktimave flet për një incidencë më të lartë të dhunës në krahasim me prevalencën në 12 muajt e fundit.
 - Në përgjithësi, për gjithë popullatën është verifikuar prevalencë prej 37,7% për të gjitha llojet e dhunës në familje, ndërsa vetëm për gratë është më e lartë (39,4%), ndërsa për meshkujt është më e ulët (35,5%).
 - Prevalenca e dhunës tek gratë është më e lartë se sa tek meshkujt (dallimi është 4.1 përqind poena), gratë relativisht përjetojnë shumë më tepër dhunë se sa meshkujt (dallim prej 17.6 përqind poena) dhe gjithashtu ekziston një raport më i lartë në kuadër të grupit të grave.
 - Njëkohësisht, ekziston rrezik i posaçëm që gratë më të reja të përjetojnë dhunë në familje, ndërsa tek gratë në moshë deri më 49 vjeç ekziston prevalencë më e lartë nga prevalenca mesatare e dhunës në familje tek gratë (39.4%).
 - Mirëpo, edhe tek grupi më i ri i meshkujve madhor (15-29 vjeç) ekziston një prevalencë shumë e lartë e dhunës në familje (mbi prevalencën mesatare prej 35,5%). Duke pasur parasysh strukturën kryesisht të re të popullatës në vend, një e dhënë e këtillë është alarmante.
 - Prevalenca e lartë e dhunës në familje tek të rinjtë është nën ndikim të madh të disa variableve ekonomike, siç është punësimi, produktiviteti, investimi në kapitalin njerëzor, ndikimi i madh mbi rezultate afatshkurtër dhe afatgjatë mbi rezultatet shëndetësore, etj.
 - Kur bëhet fjalë për burrat, vetëm për moshën dhe për vendbanimin është vërtetuar të kenë ndikim të madh mbi probabilitetin për dhunë psikike apo fizike.
 - Sipas rezultateve të hulumtimit, më tepër se një e treta e popullatës (36,8%) në Republikën e Maqedonisë kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës psikologjike në familje. Pjesa më e madhe e dhunës psikologjike që ndodh nëpër amvisëri në Republikën e Maqedonisë shpesh është e shoqëruar me mlllef, restriksione, ndalesa, dyshime, sjellje kontrolluese. Dhuna ekonomike dhe dhuna që përfshin ofendim, nënçmim dhe kërcënim ndodh në një numër më të vogël të amvisërive.
 - Dhuna fizike dhe seksuale kanë prevalencë të ulët, gjë që mund të shpjegohet me kufizime metodologjike të studimit. Por, tek dhuna fizike, prevalenca tek gratë është tre herë më e lartë se tek meshkujt. Gjithashtu, përqindja në kuadër të grupit të grave është tre herë më e lartë dhe numri i grave që kanë përjetuar dhunë fizike tejkalon këtë raport përqindjesh (78% e të gjithë të anketuarve që kanë deklaruar të kenë përjetuar dhunë fizike janë gra). Analiza sipas moshës shpie në konkludimin se, mes të anketuarve që kanë përjetuar dhunë fizike, numri më i madh i tyre i takon grupit më të moshuar të grave, ndërsa tek burrat numri më i madh paraqitet tek meshkujt më të rinj. Rreth 60% e grave të anketuara që kanë përjetuar dhunë fizike janë në moshën prej 30 deri në 64 vjeç.
 - Autorët dominant të të tre llojeve të dhunës janë burrat: 53% në rastet e dhunës psikologjike, 76% në ato për dhunë fizike dhe 100% tek rastet e dhunës seksuale. Sipas relacioneve të autorit të dhunës me viktimën tek dhuna psikologjike, në 34% të rasteve ushtruesit e dhunës janë prindërit, ndërsa në 56% janë ose bashkëshortet ose bashkëshortët. Elementi që meriton një vëmendje të veçantë është e dhëna që 10% e dhunës psikologjike është ushtruar nga anëtarë të tjerë të amvisërisë. Pak më ndryshe qëndron gjendja me dhunën fizike në aspekt të relacionit të ushtruesit të dhunës me viktimën. Konkretisht, në 41% të rasteve autorët e dhunës fizike janë partnerët bashkëshortor, ndërsa në 31% këtë e bëjnë prindërit. Anëtarët tjerë të amvisërisë, gjithashtu kanë një pjesëmarrje të lartë në ushtrimin e dhunës fizike (18%).
 - Faktorë më të rëndësishëm që rrisin probabilitetin për dhunë ndaj grave janë mosha e tyre, statusi i tyre arsimor, numri i fëmijëve që jetojnë në amvisëri, vendbanimi (vend

urban apo rural). Statusi arsimor është ngusht i lidhur me punësimin dhe faktorët tjerë ekonomik.

- Varësia ekonomike e grave nga burrat njëkohësisht paraqet edhe pasojë por edhe faktor për një rrezik më të madh të paraqitjes së dhunës. Gratë që nuk janë të punësuar, gjegjësisht aktive, kanë prevalencë shumë më të lartë të dhunës nga prevalenca mesatare, ndërsa gratë që janë të punësuar kanë prevalencë më të ulët. Shumica e grave që përjetojnë dhunë janë të papunësuar, gjegjësisht joaktive (gjithsej 80%), ndërsa gratë e punësuar përfaqësohen me rreth 20% në numrin e përgjithshëm të grave që përjetojnë dhunë. Variablet ekonomike kanë domethënie të madhe në të kuptuarit e prevalencës të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë. Edhe sipas statusit të punësimit, edhe sipas nivelit të plotësimit të nevojave për shpenzime në amvisëri, rezultatet e hulumtimit japin indikacione konzistente që gratë janë në rrezik shumë më të madh për t'iu nënshtruar dhunës se sa burrat.
- Ngushtë i lidhur me statusin e punësimit dhe me varfërinë është niveli i arsimit. Sipas rezultateve të hulumtimeve, tek gratë ekziston një linjë e kundërt proporcionale mes nivelit të arsimit dhe rrezikut për të përjetuar dhunë. Gjegjësisht, sa më i ulët niveli i arsimit, aq më i lartë është rreziku për të përjetuar dhunë. Një prevalencë shumë më e lartë e dhunës në familje është prezente tek gratë me arsimim fillor apo arsimim të papërfunduar fillor, rreth 80% e të anketuarave me arsim fillor apo më të ulët janë deklaruar se kanë përjetuar ndonjë lloj të dhunës në amvisëritë në të cilat jetojnë momentalisht, që përbën gjysmën e të gjitha grave të anketuara.
- Sipas përkatësisë etnike, gratë e komunitetit maqedonas dhe komunitetit serb kanë prevalencë më të ulët të dhunës në familje për dallim nga gratë e komuniteteve tjera etnike. Gjendja tek gratë e komunitetit romë është në veçanti alarmante me prevalencë prej 72,2%.
- Sipas vendbanimit, vend urban apo rural, prevalenca e dhunës në familje në mjediset rurale është më e lartë edhe për burrat edhe për gratë. Por, prevalenca për gratë në mjediset rurale është shumë më e lartë se ajo e burrave (dallim prej 7 përqind poena), ndërsa në mjediset urbane dallimi me burrat është rreth 2 përqind poena.
- Ekziston lidhje e qartë e drejtpërdrejtë mes prevalencës së dhunës në familje dhe numrit të anëtarëve në amvisëri, gjegjësisht, prevalenca rritet me rritjen e numrit të anëtarëve të familjes.
- Të anketuarit që kanë përjetuar dhunë në familje shpesh i janë drejtuar policisë, QPS-ve dhe institucioneve shëndetësore. Megjithatë, sipas llojit të dhunës dhe sipas karakteristikave të të anekuarve, institucionet më shpesh të kontaktuara apo vendet ku më shpesh është kërkuar përkrahje kategorizohen si "të tjera", që përfshin familjen apo institucionet fetare. Në fakt, më tepër se tre të katërtat e rasteve nuk janë denoncuar në asnjë nga shërbimet publike që qëndrojnë në dispozicion të këtyre personave.
- Tek të anketuarit pjesëtarë të komunitetit maqedonas ekziston probabilitet më i lartë, dhe madje janë komuniteti i vetëm etnik që do të denonconte rastet tek shërbimet shtetërore. Të anketuarit nga komuniteti shqiptar, në rast se do të vendosnin të paraqisnin rastin, atë do ta bënin në institucionet shëndetësore.
- Në rast të dhunës, ka më tepër të ngjarë që të anekuarit të informojnë ndonjë anëtar të afërm të familjes se sa rastin ta raportojnë pranë institucioneve. Mes institucioneve të identifikuar nga të anketuarit si destinacion ku do të raportonin rastin e dhunës është policia (33%), e të dytët në listë janë punëtorët social (11%). Mirëpo, 24% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk do t'i tregonin askujt për rastin, ndërsa 19% do t'u tregonin prindërve të tyre.
- Në lidhje me nivelin e kënaqësisë me kualitetin e shërbimeve që merren, të anketuarit kanë shprehur nivel të lartë të kënaqësisë me shërbimet që sigurojnë organizatat joqeveritare dhe shërbimet për mbrojtje shëndetësore.
- Nga aspekti i aktiviteteve që janë zbatuar gjatë periudhës së kaluar në drejtim të ngritjes së vetëdijes së publikut për fenomenin e dhunës në familje, 73% e të anketuarve janë deklaruar që e kanë të njohur fushatën dhe kanë shprehur qëndrim pozitiv për të.

Megjithatë, vetëm disa prej tyre kanë mbajtur mend moton kryesore të fushatës⁶.

2. Hulumtimi nacional, „Prevalenca e keqtrajtimit të personave të moshuar“, që u zbatua në vitin 2011 nga Instituti për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike – Shkup, i mbështetur nga Organizata botërore shëndetësore kishte për qëllim të hulumtojë fenomenin e dhunës dhe keqtrajtimit të personave të moshuar dhe të mundësojë identifikimin e prevalencës së dhunës në familje dhe keqtrajtimit të personave të moshuar, të identifikojë format dominante të dhunës dhe keqtrajtimit të personave të moshuar dhe të identifikojë ushtruesit e dhunës. Ky hulumtim është i pari i këtij lloji në vend dhe është inspiruar nga identifikimi i keqtrajtimit të personave të moshuar si problem shëndetësor në Raportin nacional për dhunë dhe shëndet⁷.

Hulumtimi është zbatuar në territorin e Republikës së Maqedonisë mbi një shembull ku janë përfshirë 960 të anketuar (429 burra dhe 530 gra) të moshës mbi 65 vjeç që jetojnë në amvisëri private. Hulumtimi në teren është zbatuar gjatë muajit dhjetor të vitit 2011, përmes metodës hulumtuese bisedë kokë-më-kokë dhe përmes pyetësorit, si teknikë për grumbullim të të dhënave⁸.

- Sipas rezultateve të hulumtimit, 34,6% e personave mbi 65 vjeç kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës, keqtrajtimit apo neglizhencës;
- Shumica e të anketuarve kanë përjetuar një lloj keqtrajtimi (59,02%), ndërsa 24,78% e të anketuarve kanë përjetuar dy lloje të keqtrajtimit, dhe 16,2% kanë përjetuar më tepër se tre lloje të keqtrajtimit;
- Keqtrajtimi psikologjik është forma më e shpeshtë e dhunës, gjegjësisht 25,73% e të anketuarve kanë deklaruar që kanë përjetuar keqtrajtim psikologjik, 11,98% e të anketuarve kanë përjetuar keqpërdorim financiar, ndërsa 8,86% e të anketuarve kanë përjetuar keqtrajtim fizik dhe lëndim. Neglizhencë është raportuar nga 6,53% e të anketuarve. Forma e dhunës që më së paku është raportuar është keqtrajtimi seksual (1,35%);
- Ushtruesit më të shpeshtë të dhunës ndaj personave të moshuar janë partneri apo bashkëshorti, djali dhe nusja. Varësisht nga lloji i dhunës, pozitë dominante të ushtruesit të dhunës ka partneri, djali dhe nusja. Ushtruesi më i shpeshtë i dhunës psikologjike është djali (29,55%), më pas janë partneri (25,51%) dhe nusja (22,62%). Dhuna fizike më së shpeshti ushtrohet nga partneri (30,91%), nusja (23,64%) dhe djali (20,00%). Ushtrues i dhunës financiare në 47% të rasteve është djali dhe partneri në 10% të rasteve. Ushtrues dominant i dhunës seksuale është partneri ose ndonjë person tjetër të cilin viktimat e njej.
- Gratë më të moshuara janë shumë më shpesh viktimat të të gjitha llojeve të dhunës. Përkatesia gjinore ka domethënie relevante si faktor rreziku për dhunë ndaj personave të moshuar. Sjellja e autorit mund të ndërlidhet me karakteristika biologjike, gjegjësisht, gratë janë fizikisht më të dobëta dhe zakonisht nuk mund të mbrohen. Nga rezultatet e hulumtimit, është evidente që gratë më së shpeshti u nënshtrohen të gjitha llojeve të dhunës, vetëm për shkak se janë gra.
- Përkaj gjinisë si faktor dominant rreziku për dhunë ndaj personave të moshuar, arsimimi, gjegjësisht niveli më i ulët i arsimit është faktor rreziku për dhunë. Depresioni është faktori i tretë rreziku, gjegjësisht, personat e moshuar me nivel më të ulët të depresionit janë më të ekspozuar në dhunë se sa personat me nivel më të lartë të depresionit.

Trajtimi i çështjes së dhunës ndaj personave të moshuar në Republikën e Maqedonisë rrit dukshmërinë e këtij fenomeni shoqëror, me çka viktimave u mundësohet që të informohen për të drejtën e tyre për jetë pa dhunë, ndërsa autorëve të njohin modelet e tyre të sjelljes dhe pasojat nga ajo.

⁶ Vilagozmez, E., Rikalovski, V., Popovska, L. (2012), „Hulumtim nacional për dhunë në familje“, UNDP, Shkup

⁷ Raport për dhunën dhe shëndetin në Maqedoni dhe doracak për parandalim. (2006), Ministria e shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë, Shkup.

⁸ Markovik, M., Jordanova Pesevska, D., Sethi, D., Serafimovska, E., Kishman, M., (2012), „Prevalenca e keqtrajtimit të personave të moshuar“, WHO, Shkup.

3. Në kuadër të hulumtimit „Të keqtrajtuar e të njollosur“ – Analizë e gjendjes rreth keqtrajtimit seksual të fëmijëve, të zbatuar në vitin 2009 nga Instituti për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike – Shkup, i mbështetur nga Zyra e UNICEF-it në Shkup, janë analizuar të dhënat ekzistuese, si dhe dinamika dhe dukuria e keqtrajtimit seksual të fëmijëve në vend. Janë analizuar edhe kapacitetet ekzistuese të institucioneve shtetërore për mbrojtje të fëmijëve nga keqtrajtimi seksual. Studimi është dizajnuar me qëllim që të identifikohet vëllimi dhe format e keqtrajtimit seksual të fëmijëve në vend, të verifikohen karakteristikat e fëmijëve viktimat të keqtrajtimit seksual dhe të profilizohen ushtruesit e këtij lloji të keqtrajtimit, si dhe të zbulohen rrethanat që kontribuojnë për keqpërdorim seksual të fëmijëve.

Hulumtimi është zbatuar nga 1 korriku dhe në 30 nëntor të vitit 2009 dhe të dhënat e grumbulluara kanë të bëjnë me periudhën janar 2004 - qershor 2009. Shtrirja e hetimit është bazuar në rastet e evidentuara në institucionet e sistemit (QPS dhe gjykata). Gjithashtu, në hulumtim janë përfshirë edhe personat profesionistë të sistemit (të punësuar në polici, QPS, shkolla, kopshte për fëmijë dhe institucione shëndetësore).

- Sipas rezultateve të hulumtimit, statistika zyrtare jep vetëm një pjesë të fotografisë së përgjithshme për keqtrajtimin e fëmijëve, gjegjësisht, nuk siguron informata për përfaqësimin e formave të ndryshme të keqtrajtimit seksual të fëmijëve, që është rezultat i metodologjisë së mbajtjes së statistikave sipas ushtruesit të veprës dhe jo sipas viktimave.
- Pjesa më e madhe e fëmijëve që janë keqtrajtuar seksualisht janë vajza, gjegjësisht në 78% të rasteve. Në anën tjetër, numri më i madh i ushtruesve të dhunës janë burra (93%). Edhe pse vajzat janë më së shumti të përfaqësuara në numrin e përgjithshëm të fëmijëve viktimat, djemtë e moshës deri më 6 vjeç janë viktimat më të shpeshta në krahasim me vajzat e po të njejtës grupmoshë. Me rritjen e moshës tek vajzat rritet rreziku për keqtrajtim seksual.
- Sipas përkatësisë etnike, edhe pse numri më i madh i fëmijëve viktimat janë pjesëtarë të përkatësisë etnike maqedonase, grupi më i ndjeshëm etnik janë fëmijët romë, ndërsa më së paku të përfaqësuar si fëmijë viktimat janë pjesëtarët e komunitetit shqiptar.
- Fëmijët viktimat jetojnë në familje më të mëdha në krahasim me popullatën e përgjithshme. Jo rrallë herë ata janë pjesë e familjeve të cilat ballafaqohen me një sërë problemesh tjera: kushte të këqija shtëpiake (31%); papunësi të prindërve (tek 25% të dy prindërit janë të papunë); dhe varësi nga shfrytëzimi i rregullt i ndihmës sociale (34%). Dhuna në familje është raportuar tek e katërta e këtyre familjeve.
- Njëkohësisht, sipas rezultateve të hulumtimit, fëmijët ballafaqohen me rrezik më të madh nga dhuna seksuale nga rrethi i tyre më i ngushtë. Në vetëm 12,5% të rasteve, ushtruesi i dhunës ka qenë person i njohur për fëmijën.
- Shumica e personave të dënuar për keqtrajtim seksual të fëmijëve (83%), kanë qenë autorët primar të veprës.
- Përbërja etnike e ushtruesve të gjykuar të keqtrajtimit seksual tregon që ata u përkasin të gjitha komuniteteve etnike që jetojnë në vend⁹.

1.1.2 Të dhëna statistikore për rastet e raportuara të dhunës në familje pranë organeve kompetente

Paraqitja e të dhënave statistikore për rastet e raportuara të dhunës në familje nëpër institucione ka për qëllim që të fitohet një pasqyrë për dinamikën e dhunës së raportuar në familje, si dhe për shërbimet që u janë ofruar viktimave, që sigurisht se paraqet vetëm prekje mbi sipërfaqen e gjendjes aktuale me dhunën në familje në Republikën e Maqedonisë. Sidoqoftë,


⁹ Çaçeva, V. dhe Mirçeva, S., (2010) „Të keqtrajtuar dhe të njollosur“ - Analizë e gjendjes: keqtrajtim seksual i fëmijëve. UNICEF, Shkup, faqe.8.

është tejet e vështirë dhe pothuajse e pamundur që të prezantohen të dhëna të sakta për numrin e përgjithshëm të viktimave të dhunës në familje për shkak se grumbullimi i të dhënave që kanë të bëjnë me fenomenin e dhunës në familje akoma nuk është konsoliduar. Gjendja e këtillë rezulton me validitet të zvogëluar të të dhënave.

Në këtë dokument janë dhënë të dhënat statistikore për rastet e raportuara të dhunës në familje të cilat i grumbullojnë dhe përpunojnë dy institucione, Ministria për punë të brendshme dhe Ministria për punë dhe politikë sociale. Këto janë institucionet e vetme të sistemit që kanë ndërtuar metodologji të vet specifike për grumbullim dhe regjistrim të evidencave statistikore për rastet e raportuara të dhunës në familje.

Në grafikun e rradsës janë dhënë të dhënat për numrin e rasteve të regjistruara të dhunës në familje në Ministrinë për punë të brendshme për periudhën 2008-2011. Është e evidente që të dhënat që grumbullohen nga ky institucion janë për vepra penale dhunë në familje dhe për shkelje dhe ankesa. Është vënë re trend i vazhdueshëm i një rritjeje të vogël të rasteve të raportuara të veprave penale dhunë në familje, dhe rritje e numrit të ankesave për dhunë në familje.

Grafikoni 1. Numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara të veprave penale, shkeljeve dhe ankesave për dhunë në familje sipas Analizës së MPB për 2008-2011




*Burimi: www.moi.gov.mk

Të dhënat statistikore janë ndarë sipas gjinisë së viktimës dhe ushtruesit të dhunës, relacionit mes të dyve, llojit të veprës penale dhe shkeljes dhe sipas vendit ku është raportuar rasti.


Në grafikun nr. 2 janë prezantuar autorët e rasteve të raportuara të dhunës në familje të ndarë sipas gjinisë. Është e dukshme që në rastet e raportuara, ushtrues dominant të dhunës janë persona të gjinisë mashkullore, ndërsa pjesëmarrja e grave në rastet e raportuara është simbolike në raport me numrin e burrave.

Grafikoni 2. Ushtruesit e dhunës në familje të ndarë sipas gjinisë




Krejtësisht e kundërta nga Grafikoni 2, në Grafikun 3, ku është dhënë struktura gjinore e viktimave, qartë mund të shihet që viktimat dominante të rasteve të raportuara të dhunës në familje janë gra, ndërsa si ushtrues të dhunës paraqiten kryesisht persona të gjinisë mashkullore.

Grafikoni 3. Viktima të dhunës në familje sipas gjinisë



Në lidhje me relacionin mes viktimës dhe ushtruesit të dhunës, të dhënat statistikore të MPB-së për rastet e raportuara të dhunës në familje flasin që viktimë dominante e të gjitha formave të dhunës në familje është bashkëshortja. Te dhuna seksuale, bashkëshortja është viktimë e vetme, ndërsa te dhuna psikologjike është vënë re që përkaj bashkëshortes, si viktimë paraqitet nëna, ish-bashkëshortja, djali, ndërsa si viktimë shumë më pak paraqiten bashkëshorti dhe babai. Nga ana tjetër, te dhuna fizike edhe pse si viktimë dominon bashkëshortja, është vënë re pjesëmarrje më e madhe e babait si viktimë. Tek format më të rënda të dhunës fizike si "vrasje", përkaj bashkëshortes, si viktimë e dytë dominante paraqitet djali.

Grafikoni 4. Struktura e viktimave sipas relacionit me autorin e dhunës




Institucioni i dytë që grumbullon të dhëna statistikore për dhunën në familje është Ministria për punë dhe politikë sociale (MPPS). Këto të dhëna kanë të bëjnë para së gjithash me strukturën e viktimave dhe me llojin e shërbimeve të ofruara.

Në periudhën e analizuar 2008-2011 vihet re një rritje e përgjithshme e aktiviteteve të QPS-ve në lidhje me rastet e dhunës në familje. Në Grafikun 5 është dhënë dinamika e raportimit të dhunës në familje pranë MPPS-së, së bashku me aktivitetet e ndërmarra sipas viteve. Fakt

i pamohueshëm është se një numër shumë i vogël i grave-viktima paraqiten si shfrytëzues të shërbimeve, por është vërejtur një trend oscilues në raportim të rasteve, që njëkohësisht tregon rritje minimale. Në anën tjetër, edhe përkaj numrit të vogël të grave-viktima shfrytëzuese të shërbimeve, në pjesën e aktiviteteve të zbatuara vërehet rritje e vazhdueshme dhe stabile e masave që QPS-të i propozojnë para gjykatave, si dhe në masat e shqiptuara nga gjyqi. Vendosija e viktimave në strehimore qëndron relativisht stabile nga viti në vit. Në periudhën e analizuar prej 4 vitesh, numri i masave të propozuara për mbrojtje të viktimave është rritur për më tepër se dy herë e gjysëm, gjë që është përcjellur me rritje të njejtë të masave të shqiptuara. Gjatë interpretimit të të dhënave statistikore mbi aktivitetet e MPPS-së në lidhje me rastet e raportuara të dhunës në familje, bie në sy mungesa e mekanizmave për ndjekje dhe monitorim të efikasitetit të masave dhe kjo paraqet sfidë për strategjinë e re. Këto të dhëna mund të interpretohen në drejtim të vetëdijes së rritur të popullatës për jotolerancën shoqërore ndaj këtij fenomeni dhe për përgjigjen institucionale që vjen si konsekuencë.


Grafikoni 5. Aktivitete të MPPS-së në lidhje me rastet e raportuara të dhunës në familje



Përkaj dinamikës së masave të propozuara e të shqiptuara, gjithashtu, interesante për t’u ndjekur është edhe struktura dhe dinamika në strukturën e masave të shqiptuara për mbrojtje. Në një periudhë të analizuar prej dy vitesh, është vënë re rritje e përgjithshme në shqiptimin e masave për mbrojtje. Njëkohësisht, vie në shprehje një rritje e shumëfishtë e shqiptimit të masës mjekim i domosdoshëm i ushtuesit të dhunës. Një masë tjetër që shënon rritje çdo vit është masa ndalesë për shqetësim, e ndjekur me masën ndalesë për kërcënim. Gjithashtu, ekziston rritje në shqiptimin e masave rikthim të mjeteve nga ana e ushtruesit të dhunës që janë të nevojshme për të plotësuar nevojat e përditshme të familjes, si dhe të masës për vizitë të qendrave për këshillim nga ana e ushtruesit të dhunës.


Në anën tjetër, është vërejtur rënie në shqiptimin e masave ndalesë për afrim, ndalesa për posedim të armëve zjarri apo ndonjë lloji tjetër arme ose të konfiskimit të armës, si dhe të masës për sigurim të detyrueshëm të mjeteve për përkujdesje të familjes.

Grafikoni 7. Struktura e masave të shqiptuara për mbrojtje



Në aspekt të strukturës etnike të viktimave, dominojnë viktimat e përkatësisë etnike maqedonase me një dinamikë relativisht stabile gjatë viteve. Përfaqësimi i grave maqedonase në strukturën e përgjithshme të grave viktima që janë evidentuar nga QPS-të është në përputhje me pjesëmarrjen e grave të përkatësisë etnike maqedonase në strukturën e përgjithshme të grave në vend. Brengos rënia e vazhdueshme e grave të përkatësisë etnike rome, që ka karakter të një rënie të vazhdueshme, dhe të grave të përkatësisë etnike shqiptare viktima që kanë shfrytëzuar shërbimet e QPS-ve. Kjo e dhënë posaçërisht duhet të nxisë një analizë të thellë nga MPPS-ja për arsyet që shpien në rënie të numrit të grave rome dhe shqiptare në strukturën e shfrytëzuesve të shërbimeve në lëminë e dhunës në familje.

Grafikoni 6. Struktura e viktimave sipas etnitetit



1.1.3. Korniza juridike për trajtim të çështjes së dhunës në familje

1.1.3.1. Mbrojtja penalo-juridike

Sistemi penalo-juridik i Maqedonisë bën dallimin e veprave penale në kontekst të dhunës në familje¹⁰. Në kodin penal nuk parashihet inkriminim vetanak, i posaçëm i dhunës në familje. Përkundrazi, sjellja e dhunshme ndaj një anëtari të familjes apo ndaj ndonjë personi në lidhje të afërt intime është e inkriminuar në më tepër vepra penale. Idea për një zgjidhje të tillë bazohet në seriozitetin e dëmit nga një sjellje e caktuar e dënueshme me ligj. Është miratuar qasja që dhuna në familje është po aq vepër e rëndë penale sa edhe veprat e rënda penale. Por, njëkohësisht definohet edhe si sjellje e dënueshme specifike, me atë që relacioni i afërsisë dhe intimitetit mes ushtruesit të dhunës dhe viktimës bëhet element kualifikues.

Ndlesa penalo-juridike për dhunë në familje përcakton edhe pozitën e shtetit ndaj familjes, gjegjësisht, pranohet parimi i zyrtarizimit të përndjekjes për vepra penale dhunë në familje. Fakti që për raste kur është bërë vepër dhunë në familje përndjekja ndërmerret si detyrë zyrtare dhe dënimi është më i rreptë në krahasim me formën bazë, sjell mbrojtje të posaçme për anëtarin e familjes nga ana e shtetit.

Definicioni i dhunës në familje i përfshirë në Kodin penal përcakton llojet e dhunës në familje, aktin e kryerjes, pasojat e shkaktuara, cilësinë e autorit dhe objektin e mbrojtjes. E drejta penale e Maqedonisë njeh dhunën seksuale, psikike dhe fizike – si forma të dhunës në familje. Prej këtuj, edhe veprat penale që përfshijnë dhunë në familje janë vendosur nëpër kapituj të ndryshëm të Kodit penal në bazë të objektit të ndryshëm për mbrojtje (Kapitulli XIV – Vepra penale kundër jetës dhe trupit; Kapitulli XV – Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit; Kapitulli XIX – Vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor. Karakteristika e ardhshme e zgjidhjes aktuale ligjore është që vendi i ngjarjes, gjegjësisht, a ndodh vepra në publik apo në privatitetin e shtëpisë nuk ka kurfarë domethënie për ekzistimin e veprës. Njëkohësisht, nuk ekziston dispozitë që në veçanti mbron fëmijët kur janë dëshmitarë apo kur shohin pasojat nga dhuna në familje.

Qëllimi i ligjdhënësit që dhunën në familje ta inkriminojë si vepër e kualifikuar penale, pa dyshim që bazohet në nevojën për mbrojtje efikase penalo-juridike të viktimave të dhunës në familje. Zgjidhjet ligjore përmbajnë një porosi të qartë për vendosshmërinë e shtetit për të ndërmarr masa të rrepta në parandalimin e dhunës në familje dhe për të siguruar mbrojtje për viktimat. Kualifikimi nënkupton dy aspekte: përcaktimi i dënimeve më të mëdha, dhe përndjekje në mënyrë zyrtare për të gjitha veprat penale dhunë në familje. Vetëm në raste të veprës penale – Lëndim trupor, përndjekja varet nga vullneti i viktimës, që shprehet përmes një propozimi të dorëzuar. Pikërisht serioziteti i pasojës që është shkaktuar nga vepra penale, ndenja e pasigurisë, rreziku ose frika, në kombinim me cilësinë e ushtruesit të dhunës, ndaj partnerit bashkëshortor, prindit ose fëmiut apo ndaj personave të tjerë që jetojnë në bashkësinë martesore apo jashtëmartesore apo në amvisërinë e përbashkët, si dhe ndaj ish partnerit apo personit me të cilin ushtruesi i dhunës ka fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të afërta personale, në ambient familjar, në një shtëpi apo marrëdhënie personale ku njerëzit duhet të ndjehen të sigurtë, përcakton kualifikimin e veprës penale bazë. Për më tepër, veprat më të rënda penale ndiqen në mënyrë zyrtare për shkak se ato rrezikojnë vlerat themelore që mbron Kodi penal, me çka verifikohet qëllimi i ligjdhënësit për të barazuar mbrojtjen penalo-juridike nga dhuna në sferën private dhe atë publike.

Për veprat penale në kontekst të dhunës në familje janë paraparë dënime me burg në kohëzgjatje prej tre muajsh e deri në dhjetë vite apo me burg të përjetshëm. Me ndryshimet e fundit të vitit 2009 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 114/2009), në kuadër të mbikqyrjes mbrojtëse të dënimit me kusht për herë të parë është vënë në përdorim detyrimi për “pjesëmarrje në programin për punë me persona të dënuar për vepra penale dhunë në familje”, dhe e njëjta ka hyrë në fuqi në vitin 2011.

10 Shih më gjerësisht, Mirçeva, S. (2011), „Analizë të legjislacionit nacional dhe identifikim i fushave bazë që duhet të vihen në përputhje me dispozitat e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalim dhe kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – CAHVIO“, UNDP.Shkup

Legjislativa penale iu nënshtrua një reforme rrënjësore, gjë që rezultoi me miratimin e Ligjit të ri për procedurë penale në nëntor të vitit 2010¹¹. Gjithëpërfshirja e ndryshimeve kërkonte që ligji i ri të hynte të fuqi më vonë. Fillimi zyrtar i cilësdo fazë të procedurës penale nuk do të thotë me automatizëm fillim i mbrojtjes së viktimës nga dhuna e mëtejshme apo nga rreziku. E drejta penale e Maqedonisë vepron mbi bazën e dëmtuar nga një vepër penale, “i dëmtuar është çdo person viktimë e një veprë penale i cili ka pësuar dëm, përfshirë lëndim fizik apo mental, vuajtje emocionale, humbje materiale apo ndonjë dëm tjetër ose rrezikim të lirive dhe të drejtave të tij bazë si pasojë e ndonjë veprë penale” (neni 139 nga LPP). Termi viktimë fillon të përdoret për herë të parë në Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Kodit penal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2008) ku “me termin viktimë e një veprë penale nënkuptohet çdo person që ka pësuar dëm, përfshirë lëndim fizik apo mental, vuajtje emocionale, humbje materiale apo ndonjë dëm tjetër ose rrezikim të lirive dhe të drejtave të tij bazë si pasojë e ndonjë veprë penale”. Definicioni i njejtë për termin viktimë është pranuar dhe është përdorur edhe në dispozitat e Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurë penale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 83/2008).

I dëmtuari, gjegjësisht viktimat në procedurën penale nuk është palë procesuese dhe ka cilësinë e subjektit dytësor. I dëmtuari është bartës i të drejtave të caktuara procedurale kur nuk paraqitet si paditës privat, ndërsa kryesisht këto të drejta shndërrohen në pjesëmarrje aktive në dorëzimin e kërkesës juridiko-pronësore në procedurën penale. Gjithashtu, qëllimi i procedurës penale në Maqedoni është që të rrisë të drejtat procedurale të personit të dëmtuar dhe të balancojë ato me të drejtat e të akuzuarit.

Por, në aspektin e viktimave të dhunës në familje, primare është çështja e trajtimit të gjithë sistemit penalo-juridik në të gjitha fazat e procedurës në lidhje me sigurimin e mbrojtjes nga viktimizimi dhe me realizimin e interesave dhe nevojave të viktimës. Tradicionalisht, i tërë sistemi penalo-juridik është i drejtuar kah vepra penale dhe kah ushtruesi i dhunës dhe nuk merret me nevojat e viktimave dhe trajtimin e tyre gjatë zbatimit të procedurës penale.

1.1.3.2. Pozita e viktimës së dhunës në familje sipas Ligjit të ri për procedurë penale

Reforma e legjislaturës penale në Maqedoni bën një ndryshim serioz në drejtim të të drejtave të viktimave. Ligji i ri për procedurë penale miraton dhe definon termet viktimë dhe i dëmtuar, ku qartë janë definuar domethëniet e të dy termeve. Theksi është vënë në të drejtat për pjesëmarrje në procedurë dhe të drejtat për informim, mbrojtje, ndihmë dhe përkrahje, dhe dëmshpërblim¹².

Domethënie të veçantë ka dispozita për të drejtat themelore të viktimave që është pjesë e nenit 53 të LPP-së së re. Të drejtat e parapara themelore të viktimës përbëhen nga e drejta për pjesëmarrje në procedurë si i dëmtuar duke iu bashkangjitur përndjekjes penale ose duke realizuar të drejtën për dëmshpërblim, të drejtën për përkujdes të veçantë nga organet dhe subjektet që marrin pjesë në procedurën penale, të drejtën për ndihmë profesionale psikologjike apo të ndonjë lloji tjetër dhe për mbështetje nga organet, institucionet apo organizatat që sigurojnë ndihmë për viktimat e veprave penale.

Përveç definimit të të drejtave themelore të viktimave, dobi e veçantë që sjell LPP-ja e re është miratimi i të drejtave të veçanta për viktimat. Për herë të parë njihen kategori të ndryshme të viktimave. Neni 54 parasheh masa të posaçme gjatë procedurës dhe gjatë dhënies së deklaratës dhe gjatë hetimit të rasteve të viktimave në të gjitha fazat e procedurës. Ekzistojnë viktimat të rrezikuara dhe viktimat posaçërisht të ndjeshme.

Bazë për shfrytëzimin e masave të posaçme të mbrojtjes gjatë zbatimit të procedurës është mosha, gjegjësisht mosha e mitur, më pas rreziku për sigurinë personale të viktimës, si dhe rrethanat dhe cilësia e viktimës që mund të ndikojnë në mënyrë negative mbi kualitetin e deklaratës së dhënë. Masat e posaçme shqiptohen nga gjykata, ndërsa iniciativa mund të inicohet nga vet gjykata, nga viktimat apo nga prokurori publik. Dëshira e viktimës për shqiptim të masës

11 Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 150/2010)

12 Shih më gjerësisht, Mirçeva, S. (2011), „Analizë të legjislacionit nacional dhe identifikim i fushave bayë që duhet të vihen në përputhje me dispozitat e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalim dhe kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – CAHVIO“, UNDP.Shkup

së posaçme për mbrojtje gjatë procedurës patjetër duhet të merret parasysh. Gjykata mund të shqiptojë njëkohësisht një apo më tepër masa mbrojtëse.

Përveç definimit të kategorive të ndjeshme të viktimave dhe të drejtave të tyre të posaçme, Ligji i ri për procedurë penale gjithashtu siguron të drejta të posaçme për viktimat e dy llojeve apo grupeve të veprave penale, gjegjësisht për viktimat të veprave ndaj lirive gjinore dhe moralit gjinor dhe të veprave kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. Të drejtat e posaçme të viktimave të këtyre grupeve të veprave penale flasin për senzibilizim gjinor të nevojave të viktimave. Në veçanti, nevojat e grave-viktima trajtohen me të drejtën që viktimat të intervistohet nga një person i gjinisë së njejtë që nga dhënia e deklaratës së parë në polici dhe në prokurori, të drejtën për të mos u përgjigjur në pyetjet që kanë të bëjnë me jetën personale të viktimës dhe që nuk kanë të bëjnë me veprën penale, të kërkojë që hetimi të bëhet me përdorimin dhe ndihmën e mjeteve vizuele-tonike dhe të kërkojë mospërfshirje të publikut në seancën kryesore. Për të gjitha këto të drejta, viktimat duhet patjetër të jetë e udhëzuar (mësuar) para intervistimit të saj të parë, dhe e njëjta të konstatohet në formë të shkruar. Këto të drejta të viktimës nuk janë të dhëna vetëm në mënyrë deklarative, por policia, prokuroria dhe gjykata kanë për obligim të sigurojnë që viktimat është e informuar për të drejtat e saj. Kur bëhet fjalë për vepra penale të kryera në kontekst të dhunës në familje, ndërhyrja në jetën personale të viktimës nga dhuna në familje është ngushtë e lidhur me veprën dhe e domosdoshme, por viktimizimi zvogëlohet përmes zbatimit të drejtave tjera, e në veçanti të drejtës për këshilltar pa pagesë apo përfaqësues të autorizuar, mospërfshirje të publikut, si dhe të shfrytëzimit të mjeteve vizuele dhe tonike gjatë zbatimit të hetuesisë, përkatësisht shmangia e kontaktit personal me të akuzuarin. Është më se evidente se viktimat e dhunës psikike apo fizike, të përfshira në Kapitullin XV-Vepra penale ndaj jetës dhe trupit (përveç vrasjes), nuk i gëzojnë këto të drejta të posaçme. Sidomos e drejta për këshilltar pa pagesë apo përfaqësues të autorizuar dhe dhënia e deklaratës përmes mjeteve vizuele dhe tonike ka rëndësi të posaçme për gruan-viktimë të dhunës në familje në procedurën penale. Gratë-viktima të dhunës dhe të dhunës në familje, si lloj specifik i dhunës të bazuar në përkatësi gjinore, nuk janë identifikuar as në Ligjin e ri për procedurë penale si kategori e viktimave që kanë nevoja dhe interesa të posaçme e që duhet të gëzojnë të drejtat e posaçme.

1.1.3.3.Masa për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje në procedurën qytetare

Sigurimi i sigurisë dhe mbrojtjes së viktimës nga dhuna e mëtejshme, gjegjësisht, ndihmë për tejkalim të pasojave nga dhuna e përjetuar, si dhe krijimi i kushteve për integrim të viktimës në shoqëri janë qëllimet bazë që arrihen përmes sistemit të masave për ndihmë, përkrahje dhe mbrojtje të definuara në Ligjin për familje. Në kuadër të këtij sistemi është definuar kompetenca e organeve, institucioneve dhe e sektorit joqeveritar, përgjegjësia për informim dhe bashkëpunim të ndërsjellë, iniciimi i procedurave dhe monitorimi i masave të ndërmarra për mbrojtje dhe masat e shqiptuara të përkohshme për mbrojtje.

Masat për mbrojtje ndërmirren nga QPS-të, ndërsa gjykata mund të shqiptojë masë të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje. Qendrat për punë sociale (QPS) janë të obliguara të ndërmarrin masa për mbrojtje çdo herë kur janë në dijeni që ndaj një personi është ushtruar dhunë në familje. Për mbrojtje të viktimës së dhunës në familje, QPS-ja mund të ndërmerr masa për: strehim të domosdoshëm, mbrojtje shëndetësore, vazhdim të shkollimit, intervenim dhe trajtim psiko-social, këshillim, ndihmë dhe përfaqësim juridik, informim të organeve për përndjekje, kërkesë për shqiptim të masave të përkohshme për mbrojtje, dhe çdo masë tjetër që do të konsiderohet e nevojshme. Për ndërmarrje të këtyre masave intervenuese, është e mjaftueshme që QPS të jetë në dijeni, pa patur nevojë për dyshim më të madh. Karakteristikë e posaçme e masave intervenuese që ndërmerr QPS për mbrojtje, si dhe masat e përkohshme për mbrojtje që shqipton gjykata, është që të njejtat të zbatohen pavarësisht se a është ngritur apo jo procedurë penale.

Masat e përkohshme për mbrojtje të shqiptuara nga gjykata kanë për qëllim parandalimin e sjelljes së dhunshme duke shqiptuar ndalesa, urdhëresa dhe detyrime për ushtruesin e dhunës në familje.

Në bazë të monitorimit të zbatimit të kësaj rregulle u mundësua ndryshimi i Ligjit për familje të vitit 2008 dhe viktimat nuk ka të drejtë që personalisht të inicojë pranë gjykatave kompetente procedurë për shqiptim të masës së përkohshme për mbrojtje.

Monitorimi i zbatimit të masave të shqiptuara të përkohshme është nën kompetenca të QPS-së. Zbatimi i masave të shqiptuara të përkohshme për ndalesë për kërcënim, malltretim, komunikim, afrim, braktisje të shtëpisë dhe konfiskim të një arme zjarri që është në pronë të ushtruesit të dhunës janë obligim i policisë që mbulon rajonin ku jeton viktimat. Policia ka për detyrë të informojë gjykatën për zbatimin e masës së përkohshme. Raporti gjithashtu dorëzohet edhe në QPS-në kompetente për të ndjekur rastin dhe zbatimin e masave.

QPS-të ndërmarrin masat për mbrojtje në mënyrë vetanake por edhe në bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve. Është e definuar me ligj se cilat masa për mbrojtje mund të zbatohen nga ana e shoqatave të qytetarëve të regjistruara në Regjistrin e shoqatave, që është nën kompetenca të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

Ky sistem përkrahet përmes shërbimeve për parandalim, dhënie këshillash si dhe përmes formave të mbrojtjes sociale jashtë-institucionale. Ligji për mbrojtje sociale jep bazën për themelimin e qendrave për përkujdesje të viktimës nga dhuna në familje, si dhe për sigurim të përkrahjes së nevojshme psiko-sociale dhe trajtim psiko-social të ushtruesit të dhunës në familje. Puna profesionale bëhet në qendrat për këshillim për viktimat e dhunës në familje dhe në qendrat për këshillim për ushtruesit e dhunës në familje.

Në sistemin për mbrojtje sociale pritet një pjesëmarrje proaktive e njësive të vetqeverisjes lokale në identifikimin e nevojave specifike për mbrojtje sociale të qytetarëve në rajonin ku ata banojnë, përfshirë këtu edhe masat për ndihmë, përkrahje dhe mbrojtje nga dhuna në familje. Kjo rrjedh nga miratimi i Ligjit për mbrojtje sociale në vitin 2009 ku parashihet që komunat të kenë obligim për përpilim të programeve lokale për mbrojtje sociale të cilat i dorëzojnë për opinion pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale për të vlerësuar se sa janë në përputhje me aktivitetet e programeve nacionale për zhvillim të mbrojtjes sociale.

Me qëllim të sigurimit të shërbimeve adekuate për mbrojtje sociale të qytetarëve është themeluar mekanizëm për monitorim të shoqatave humanitare, shoqatave të qytetarëve, bashkësive fetare dhe shoqatave të tyre, grupeve fetare dhe organizatave joprofitabile. Të njejtat mund të paraqiten si sigurues të shërbimeve sociale, vetëm në rast se kanë pëlqimin e ministrit për punë dhe politikë sociale, të bazuar në opinionin e Komisionit për bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve. Në këtë mënyrë, evidentohet sigurimi i sigurimit shtesë të shërbimeve sociale, përfshirë edhe sigurimin e një pjese të masave për mbrojtje të viktimave nga dhuna në familje, mënyrën se si ato sigurohen dhe kualitetin e tyre.¹³

1.1.4. Rezultate nga Strategjia nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011

Strategjia nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011 vendosi një qëllim strategjik në themelimin e sistemit efikas dhe gjithëpërfshirës në Republikën e Maqedonisë për mbrojtje dhe parandalim të dhunës në familje, që realizohet përmes zvogëlimit të fenomenit të dhunës në familje dhe përmes përmirësimit të kualitetit të mbrojtjes përmes masave sistimore në lëminë e parandalimit, intervenimit, edukimit, monitorimit dhe koordinimit mes sektorëve të ndryshëm.

Realizimi i aktiviteteve është rezultat i përkushtimit, qëndrueshmërisë dhe zotimeve të personave profesionistë në institucionet shtetërore, në organizatat joqeveritare, në komunitetin akademik, vetqeverisjen lokale dhe në komunitetin afarist, si dhe i ndihmës teknike profesionale dhe mbështetjes financiare nga Programi i përbashkët i organizatave të Kombeve të Bashkuara, "Përforcimi i kapaciteteve nacionale për parandalim të dhunës në familje", përmes përkrahjes së drejtpërdrejtë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës.

1.1.4.1.Aktivitet e zbatuara

Qëllimi i posaçëm 1: Themelimi dhe zhvillimi i qasjes së koordinuar të më shumë sektorëve në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje

Pas miratimit të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formoi një Organ nacional koordinativ i përbërë nga përfaqësues të

Ibid.

ministrive dhe shoqatave relevante të qytetarëve. Kjo mundësoi një mekanizëm për pjesëmarrje dhe koordinim të plotë për zbatimin e këtij dokumenti dhe pjesëmarrje aktive në të të shoqatave të qytetarëve. Ky organ kishte mandat për monitorim të zbatimit të Strategjisë, të miratimit të Planit aksional për zbatim të qëllimeve strategjike, monitorim të progresit, vlerësim të rezultateve të arritura dhe për përpilim të raporteve mujore dhe informim të rregullt të Qeverisë së RM-së për rezultatet e arritura.

Në lidhje me zbatimin e politikës nacionale, Organi koordinativ u dëshmuua si një praktikë e mirë. Por, për një zbatim më të plotë dhe më përgjegjës të aktiviteve dhe masave strategjike, në kuadër të çdo sektori, duhet të formohen organe të brendshme ku do të marrin pjesë përfaqësues adekuatë dhe të cilët do të shërbejnë si mbështetje për përfaqësuesin e tyre në Organin nacional koordinativ. Grupi për bashkëpunim mes sektorëve përgatiti edhe Protokol të përbashkët për veprim me mekanizëm për udhëzim në rast të dhunës në familje.

Qëllimi i posaçëm 2: Parandalimi i fenomenit të dhunës në familje përmes procesit edukativo-arsimor

Për arritjen e këtij qëllimi të posaçëm:

- U trajnuan 9 këshilltarë të Entit për zhvillim të arsimit dhe 20 ndihmës nga Qendra algoritëm për zbatim dhe monitorim të trajnimeve për krijimin e programit gjithëpërfshirës për parandalim të dhunës në shkollat fillore në R. e Maqedonisë.
- Janë trajnuar liderët e 20 shkollave fillore. Nga çdo shkollë janë përzgjedhur nga 4 liderë, me qëllim të krijimit të politikës shkollore e cila do të promovojë dhe nxisë sjellje jo të dhunshme në mjedisin shkollor.
- U zbatua një hulumtim për gjendjen e dhunës nëpër shkolla dhe u përpilua raport nga ky hulumtim: „Studim për gjendjen initiale me dhunën në shkollat fillore në Maqedoni”. Gjithashtu, u përpunua një broshurë: “Ndalimi i dhunës në shkolla – udhëzues për mësime dhënë”, i dizajnuar për mësime dhënë dhe e njehta ofron dhjetë lëmi për veprim me shembuj përkatës praktik me qëllim trajtimin dhe parandalimin e dhunës në klasa dhe shkolla. Disa nga aktivitetet bazë mësime dhënë duhet menjëherë t’i zbatojnë në shkollë, siç është përdorimi i disiplinës konstruktive dhe eliminimi i dënimit fizik. Në bazë të kësaj broshure, në të ardhmen do të përpunohet doracak për mësime dhënë. Për trajnerët vendor është organizuar sesion një-ditor me ekspert ndërkombëtar për parandalim në dhunës nëpër shkolla.
- Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për arsim fillor (neni 64-a) dhe të Ligjit për arsim të mesëm (neni 58), në vitin 2001 hyri në fuqi këshillimi i prindërve që përveç që ka për qëllim të përmirësojë sjelljen e nxënësit, gjithashtu është në drejtim të zvogëlimit të dhunës dhe është detektor i madh i problemeve në lidhje me dhunën në familje. Psikologët shkollor, gjegjësisht pedagogët, realizojnë këshillimin e prindërve dhe për këtë qëllim, psikologët dhe pedagogët e 359 shkollave fillore dhe 99 shkollave të mesme u trajnuan dhe u publikua Doracaku për këshillim të prindërve të nxënësve.
- U përpilua Doracak për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në sistemin edukativo arsimor në Republikën e Maqedonisë dhe i njehti u distribua në të gjitha shkollat.

Në lidhje me parandalimin e fenomenit të dhunës në familje, ekziston nevojë për ndërmarrje të aktiviteve të mëtejshme efektive dhe të koordinuara në të gjitha fushat. Në këtë drejtim, është i nevojshëm miratimi i planeve lokale për parandalim dhe monitorim të zbatimit të tyre në kuadër të këshillave lokale për parandalim. Ky segment i rëndësishëm do të mundësojë që të fitohet një pasqyrë për gjendjen dhe nevojat për avansim të parandalimit të dhunës në familje, në pajtueshmëri me gjendjen e konstatuar në komunitetin lokal.

Qëllimi i posaçëm 3: Edukimi i strukturave profesionale

Janë zbatuar aktivitete domethënëse në drejtim të përforsimit të strukturave profesionale, ku vëmendje e veçantë i është dhënë parimit të bashkëpunimit mes sektorëve dhe ndërtimit të rrjetit të kapaciteteve lokale.

- Për këtë qëllim, janë trajnuar 559 persona profesionistë nga qendrat për punë sociale,

institucionet shëndetësore, institucionet edukativo-arsimore, të vetqeverisjes lokale dhe organizatave të qytetarëve nga 31 komuna për punë mes shumë agjensioneve për luftë kundër dhunës në familje.

- 280 profesionistë janë trajnuar për përdorimin e Protokolit të përgatitur /Mekanizëm për udhëzim për vepim të institucioneve relevante në raste të dhunës në familje për personat profesionistë në QPS, polici, shëndetësi, gjykata dhe shoqata të qytetarëve, në bashkëpunim me sektorin joqeveritar.
- 17 persona profesionistë nga QPS Shkup, MPPS dhe Agjensioni për punësim në Republikën e Maqedonisë (APRM) janë trajnuar për trajnerë për përkrahje psiko-sociale të viktimave të dhunës në familje.
- Janë trajnuar 76 persona profesionistë në 25 QPS në drejtim të përforsimit të punës profesionale për sigurim të përkrahjes psiko-sociale për viktimat e dhunës në familje.
- Janë trajnuar 30 persona profesionistë nga QPS për strandardet e QPS-ve në procedurën e trajtimit të viktimave të dhunës në familje dhe në sigurimin e ndihmës juridike.
- 15 profesionistë nga QPS, EVS dhe ESHM janë trajnuar për punë në qendra për këshillim për fëmijë dhe nëna viktimat të dhunës në familje.
- Në sektorin shëndetësor, 1560 punonjës shëndetësor (mjek të përgjithshëm, psikiatër, gjinekologë dhe mjekë të ndihmës së shpejtë) janë senzibilizuar për identifikim të hershëm dhe parandalim të dhunës në familje.
- 70 quadro universitare nga 9 fakultete: Punë dhe politikë sociale, Pedagogji, Psikologji, Fakulteti medicinal, Fakulteti juridik, Instituti për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike dhe Fakulteti për studim gjinore, Fakulteti për arsim të lartë të infermierëve, Fakulteti për siguri janë trajnuar për modulet e OSHB për parandalim të dhunës.
- 14 profesionistë janë trajnuar për punë me ushtruesit e dhunës në familje dhe për trajtim të tyre psiko-social.
- Në 5 komuna është filluar përforsimi i kapaciteteve me qëllim zhvillimin e një modeli të zbatueshëm për punë në qendrat lokale për parandalim: Strumicë, Vllandovë, Shtip, Kriva Pallankë, Kratovë, Dellçevë, Berovë.
- Me qëllim përfshirjen më të madhe të viktimave në programet për punësim, janë trajnuar 70 struktura profesionale ndaj QPS dhe APRM për punë me viktimat e dhunës në familje.
- 160 punonjës policor, gjykatës, prokurorë dhe persona profesionistë nga qendrat për punë sociale janë trajnuar për zbatim në praktikë të procedurës në rast të dhunës në familje dhe për ndërmarrje të koordinuar të masave ligjore mes QPS dhe punonjësve policor. Trajnimi është bërë përmes 8 trajnimeve një-ditore nga Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik, Ministria për punë dhe politikë sociale dhe Ministria për punë të brendshme.
- 29 gjykatës, 16 prokurorë së bashku me personat profesional nga QPS janë trajnuar për themelimin e një mekanizmi të koordinuar midis QPS dhe gjykatave për elementet kyçe të mbikqyrjes të të drejtave prindërore për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje.
- Në kuadër të përforsimit të kapaciteteve të personave profesionistë në qendrat për mbrojtje sociale, në vijim është procesi i licencimit. Enti për veprimtari sociale miratoi Programin për edukim fillestar dhe në kontinuitet gjatë procesit të dhënies, vazhdimet dhe marrjes së licencave për punë të personave profesional.

Nevoja për përforsim të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale është evidente në të gjithë sektorët përkatës, përfshirë edhe shoqatat civile. Në mënyrë të veçantë është e nevojshme të senzibilizohen dhe përforsohen kapacitetet e pushtetit lokal në drejtim të përfshirjes në ndërmarrjen e masave për ndihmë, përkrahje dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje. Proces i përforsimit të kapaciteteve profesionale duhet të fokusohet në zbatimin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të të gjitha strukturave profesionale në këtë fushë. Në këtë mënyrë do të sigurohet zhvillim i tyre profesional dhe efikasitet më i madh në kryerjen e kompetencave të tyre.

Qëllimi i posaçëm 4: Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje Me qëllim të sigurimit të mirëmbajtjes së qëndrueshme të SOS linjës për paraqitjen e

rasteve të dhunës në familje, është zbatuar trajnim për mirëmbajtje të qëndrueshme të SOS linjës në mirëbesim, e dedikuar për sektorin joqeveritar, me qëllim që të arrihet qasje deri tek ky shërbim në nivel lokal.

- Me qëllim që të përmirësohet cilësia e shërbimeve për ndihmë juridike janë përgatitur standarde për OJQ-të, të cilat sigurojnë ndihmë juridike pa pagesë dhe të njejtat janë pilotuar nga shtatë organizata që gjeografikisht mbulojnë 20 komuna në territorin e R. së Maqedonisë. Në periudhën prej qershorit 2010 deri në dhjetor 2011 u sigurua ndihmë juridike falas (ndihmë juridike primare dhe/ose përfaqësim në procedurat gjyqësore) për më tepër se 600 viktimat të dhunës në familje, prej të cilave 96% ishin gra. Me qëllim që të lehtësohet zbatimi praktik i standardeve u përgatit Udhëzues për OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike për viktimat e dhunës në familje.
- Është realizuar një trajnim i posaçëm për avokatë që japin ndihmë juridike për viktimat e dhunës në familje, ndërsa në bashkëpunim me Odën e avokatëve u përpilua Udhëzues për anëtarët e kësaj ode i cili ka për qëllim të shërbejë si literaturë referuese dhe si pako e dobishme e mekanizmave për avokatët që punojnë me viktimat e dhunës në familje.
- Është formuar Rrjeti i parë nacional i OJQ-ve që veprojnë në lëminë e parandalimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, që paraqet një bashkim formal të një numri më të madh organizatash në lëminë e parandalimit të dhunës në familje. I formuar në fillim si rrjet joformal i 20 organizatave anëtare, rrjeti gradualisht u shndërrua në subjekt juridik me status, me qëllime strategjike dhe prioritete të përcaktuara të veprimit.
- Udhëzimi metodologjik për punë me viktimat e dhunës në familje është reviduar me qëllim që të unifikohen procedurat e QPS dhe të njejtat të bëhen më efikase dhe më profesionale.
- Është hapur Qendra e parë për këshillim të prindërve dhe fëmijëve viktimat të dhunës në familje ku si fokus kryesor është puna me fëmijë që i përkasin kategorisë së fëmijëve në rrezik social. Mirëpo, kujdes i veçantë u kushtohet nevojave specifike të fëmijëve që ballafaqohen me dhunën në familje.
- Në hapsirat e Klinikës universitare për psikiatri në Shkup është hapur Qendra e parë për këshillim për punë me ushtruesit e dhunës në familje. Në kuadër të këtij aktiviteti janë formuluar Standarde dhe norma për punë, Program për punë për trajtim psiko-social të ushtruesve të dhunës në familje, si dhe Doracak për trajtim psiko-social të ushtruesve të dhunës.
- Në bashkëpunim me komunën e Sveti Nikollës, është mbështetur themelimi i Qendrës rajonale për strehim të viktimave të dhunës në familje në Sveti Nikollë, që mbulon rajonin e Vardarit me 9 komuna dhe me mbi 150.000 banorë.
- Gjithashtu, Ministria për punë dhe politikë sociale veçmë ka përfshirë "emancipimin ekonomik të grave viktimat të dhunës në familje" në masat aktive për punësim të grupeve të zgjedhura të synuara përmes të cilave, në vazhdimësi dhe me fillim prej vitit 2009, përgatiten programet periodike operative për punësim ku parashihen masa për vetpunësim, trajnim për profesione të caktuara deficitare dhe për aftësi dhe subvencionim të punësimeve tek punëdhënësit. Në Planin operativ të Qeverisë së RM-së për vitin 2010 janë paraparë masa për vetpunësim, trajnim për profesione të caktuara deficitare dhe për aftësi dhe subvencionim të punësimeve tek punëdhënësit. Ky program është realizuar në këto pilot komuna: Shkup, Tetovë, Manastir, Kumanovë dhe Kavadar. Me realizimin e këtij programi janë arritur këto rezultate: 20 viktimat të dhunës në familje kanë mbaruar me sukses trajnimin biznesi për menaxhim me programin dhe po punohet për biznesin e tyre; 8 viktimat të dhunës në familje janë punësuar përmes punësimit të subvencionuar dhe marrin paga në mënyrë të rregullt. Në vitin 2011 vazhdoi zbatimi i Programit për përforsim ekonomik të grave viktimat të dhunës në familje, në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, me ç'rast 29 viktimat të dhunës në familje u kyçën në Programin për përforsim ekonomik, përmes tre nën-programeve, edhe atë: vetpunësim, punësim i subvencionuar dhe trajnim për deri-kualifikim/pas-kualifikim të viktimave të dhunës në familje. Në kuadër të programit ekonomik, 253 viktimat të dhunës në familje e kaluan trajnimin psiko-social, 235 viktimat i përsosën dhe avansuan aftësitë e tyre

profesionale përmes trajnimeve për përforsimin e karrierës, ndërsa 237 përfaqësues të sektorit privat janë bashkangjitur dhe janë sensibilizuar për përgjegjësinë shoqërore që kanë ndërmarrjet ndaj këtyre grupeve të ndjeshme.

- Sensibilizimi i opinionit të përgjithshëm është duke u zbatuar vazhdimisht. Në këtë drejtim çdo vit zhvillohen fushata në kuadër të 16 ditëve aktivizim kundër dhunës në familje, organizim i evenimenteve, tribuna dhe përforsim i shoqatave joqeveritare. Në vitin 2010 është zhvilluar fushatë kundër dhunës në familje me moton "Unë kam guxim dhe fuqi që ti them jo dhunës. Mundesh edhe ti!" Kjo fushatë u emitua në të gjitha televizionet kombëtare dhe radio-stacionet në katër gjuhë (shqip, maqedonisht, turqisht dhe në gjuhën rome). U botuan 100 mijë broshura, 7000 posterë, pasqyre çantash. Është organizuar evenimenti "Eliminimi i dhunës" ku morrën pjesë këngëtarë të njohur nga estrada e Maqedonisë dhe artistë pantomime. Më shumë se 300 aktivistë të OJQ-ve, anëtarë të Organit koordinativ nacional, përfaqësues nga ministritë relevante, përfaqësues nga institucionet publike, qytetarë, përfaqësues të agjensioneve të KB-ve dhe organizatave tjera ndërkombëtare, të cilët u tubuan për të krjuar një lentë ngjyrë vjollce, me çka u simbolizua zotimi i të gjithë përfaqësuesve për luftë kundër dhunës në familje.
- Në vitin 2011 u promovua një fushatë mediale për luftë kundër dhunës në familje, me moton "Të dalim së bashku nga errësira e dhunës", e cila dërgoi porosi të qartë për bashkim dhe unitet deri te të gjithë strukturat sociale në shoqëri. U promovua spot i cili u emitua në të gjitha mediat nacionale dhe u përgatitën posterë dhe broshura në gjuhën maqedonase, shqipe, turke dhe rome. Më 25.11.2011 u organizua "Marshi i ndriçimit" me qëllim të shënimit të 16 ditëve ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave.
- Desiminimi i modelit për programe preventive në komunitetin lokal, në pjesën e dhunës në familje në territorin e Maqedonisë, u zbatua përmes përzgjedhjes së 13 organizatave joqeveritare për të vendosur organe koordinative lokale për parandalim të dhunës në familje dhe zhvillim planeve aksionale në nivel lokal për veprimin e këtyre organeve.

Sensibilizimi i popullsisë së përgjithshme edhe më tej duhet përkrahur, me qëllim që sistemi i mbështetjes, përkrahjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje të afrohet deri tek të gjithë qytetarët dhe të inkurajohet denoncimi i rasteve të dhunës, me qëllim që ajo të ndalet dhe të zvogëlohen pasojat nga dhuna e përjetuar në familje.

Përparimi i mëtejshmë i sitemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje duhet të orientohet kah një qasje më e madhe e shërbimeve deri tek të gjithë qytetarët. Ndërkohë duhet të tregohet kujdes për nevojat specifike të qytetarëve në kuadër të komunës së tyre, qasje në shërbime në komunat rurale dhe të përmirësohet bashkëpunimi ndërkomunal, me qëllim që të ndërmirren masa përkatëse dhe të zhvillohen shërbime në bazë rajonale.

Qëllimi i posaçëm 5: Avansimi i sitemit civil-juridik për mbrojtje

Në Strategjinë 2008-2011 vëmendje e posaçme i është kushtuar avansimit të kornizës juridike përmes qëllimeve të posaçme 5 dhe 6.

Në drejtim të krijimit të sistemit efikas për mbrojtje, me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për familje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.84/08 nga 11.07.2008) është barazuar definicioni i dhunës në familje me Kodin penal të RM-së, me ç'rast u zgjërua rrethi i personave që mund të paraqiten si viktimat të dhunës në familje apo si agresorë-autorë të dhunës në familje, me persona me të cilët kanë relacione të afërta personale. Ndërkohë, Ligji i definon relacionet e afërta personale, si marrëdhënie personale mes personash nga gjini të kundërta, të cilët janë apo kanë qenë partnerë, dhe nuk jetojnë në bashkësi jashtë-martësore. Me këto ndryshime, u precizua afati për dorëzimin e fletëurdhërësave për të vepruar nga organet tjera kah QPS në afat prej 72 orësh, me qëllim që në mënyrë sa më efikase të mblidhet dhe të kompletohet dokumentacioni i plotë për procesimin e mëtejshmë të lëndës.

Me qëllim të marrjes së masave mbrojtëse në mënyrë sa më efikase, është paraparë kyçje preventive e sektorit civil, me përcaktimin e ingerencave të shoqatave të qytetarëve, të regjistruara për realizimin e qëllimeve dhe detyrave nga fusha e mbrojtjes sociale, në mënyrë vetanake apo në bashkëpunim me Qendrën për punë sociale, të mund të marrin masa për mbrojtje, përveç

masave që kanë të bëjnë me ngritjen e procedurave para gjykatës përkatëse, të marrin masa që kanë të bëjnë me regullimin e marrëdhënieve mes fëmijëve dhe prindërve dhe sipas nevojës të paraqesin kërkesë deri tek gjykata për shqiptimin e masave preventive të mbrojtjes. Ndërkohë, normat ligjore e vërtetojnë bashkëpunimin mes QPS dhe shoqatave qytetare, kështu që shoqata dorëzon lajmërimin dhe dokumentacionin e plotë deri tek QPS në afat prej 72 orësh pasi të jenë ndërmarrë masat për mbrojtje, pas çka QPS në afat prej 24 orësh përgatit zgjidhjen e duhur.

Njëkohësisht, me ndryshimet jepet mundësi shtesë për viktimën që përveç mënyrës indirekte përmes QPS, të mund edhe vetë pa ndërmjetësim të dorëzojë propozim në gjykatë për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje.

Ndryshimet e sistemit për ndihmë, përkrahje dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, në mënyrë të duhur janë përkrahur edhe me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për mbrojtje sociale. Me këtë rregullativë rregullohet në tërësi bashkëpunimi me shoqata të qytetarëve.

Qëllimi i posaçëm 6: Avansimi i sistemit të së drejtës penale

Korniza ligjore që ofron një mbrojtje adekuate juridiko-penale për viktimën, sanksionim dhe risocializim për ushtruesin e dhunës, është përmirësuar nëpërmjet disa ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit penal si dhe me miratimin e Ligjit të ri për procedurë penale.

Gjegjësisht, në vitin 2009 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal ("Gazeta zyrtare e RM-së numër: 114/2009") ku në nenin 56: Detyrimet për mbikëqyrje të mbrojtur, shtohet dispozita për: "Ndjekje të një programi për punë me të dënuarit për veprë penale dhunë në familje". Gjithashtu, në nenin 57: Organi për kryerjen e mbikëqyrjes së mbrojtur, krahast organit social, shtohet edhe qendra adekuate për këshillim, një organ kompetent për ndihmë dhe përkujdes, mbikëqyrje dhe mbrojtje gjatë përmbushjes së detyrave nga ana e të dënuarit.

U rindërtua legjislacioni i brendshëm për të drejtat e viktimave. Gjegjësisht, në vitin 2010 u miratua Ligji për procedurë penale ("Gazeta zyrtare e RM-së numër: 150/2010"), ku në nenet 53 deri në 56 janë inkorporuar disa risi me të cilat rregullohen të drejtat e viktimave, të drejtat e veçanta të kategorive të viktimave më të rrezikuara dhe të viktimave të veprave penale kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual, njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. Paralelisht me këto aktivitete, përfaqësuesi i Ministrisë së drejtësisë në OKN morri pjesë në aktivitete të Komitetit të Këshillit të Evropës për krijimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në vitin 2010 propozim standardet për këtë konventë u prezantuan para Organit nacional për mbrojtje nga dhuna në familje. Paralelisht me këtë proces, përfaqësuesi i Ministrisë së drejtësisë në OKN dorëzoi deri te grupi punues për përgatitjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit penal disa propozime për vendosjen e dispozitave të reja, ose ndryshimin e dispozitave ekzistuese, në përpuethshmëri me standardet e kësaj konvente.

Është përgatitur "Analizë për përpuethshmërinë e legjislacionit të RM-së me Konventën për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje". Kjo analizë jep një pasqyrë të përpuethshmërisë së ligjeve penale dhe civile, si dhe rekomandime për përpuethshmëri të mëtutjeshme të legjislacionit të RM-së me këtë konventë, me qëllim që të përparojë procesi i ratifikimit. Rezultatet e Analizës u prezantuan para Punëtorisë së mbajtur në vitin 2011. Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e rekomandimeve nga kjo analizë, në vitin 2011 u mbajt trajnim për përfaqësuesit e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, me çka u prezantuan risitë dhe standardet e kësaj konvente. Gjithashtu, me propozim të Ministrisë së drejtësisë, Qeveria më 25.5.2011 solli vendimin që Republika e Maqedonisë ta nënshkruajë këtë konventë. Këto aktivitete janë në linjë me aktivitete të parapara për këtë qëllim të veçantë të Strategjisë 2008-2011.

Sa u përket aktiviteteve për grumbullim të të dhënave nga ana e gjykatave dhe prokurorive për politikën e ndëshkimeve ndaj ushtruesve të dhunës në familje, të njëjtat nuk janë realizuar pasi që kjo paraqet një veprimtari hulumtuese shkencore e cila kërkon kapacitet njerëzor me të cilin Ministria e drejtësisë nuk disponon.

Në kuadër të këtij aktiviteti, Ministria e drejtësisë nuk disponon me të dhëna relevante statistikore sa u përket numrit të të akuzuarve dhe të dënuarve për kryerje të dhunës në familje, për arsye se të dhëna të tilla për vepra penale të veçanta nuk mbahen nga ana e Entit statistikor të RM-së. Mungesa e të dhënave të tilla e bën të pamundur ndjekjen e procesit të zbatimit të

këtyre dispozitave në praktikë dhe krijimin e një politike të ndëshkimit në këtë fushë, si dhe raportimin para organeve relevante ndërkombëtare.

Qëllimi i posaçëm 7: Krijimi i një sistemi për regjistrimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në familje nga ana e të gjitha institucioneve relevante

Procedura për krijimin e një sistemi të unifikuar nacional për mbledhjen e të dhënave për dhunë në familje ende nuk ka përfunduar, kështu që aktivitetet në atë drejtim duhet të vazhdojnë. Në RQGJ është themeluar një program softuerik për evidentimin e përdoruesve dhe formave të shërbimeve të siguruar sociale, duke përfshirë këtu edhe viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje. Por, ende vazhdon të jetë prezente nevoja për unifikimin e bazave të të dhënave në të gjithë sektorët, krijimi i një rrjeti mes tyre, si dhe krijimi i një baze nacionale të të dhënave. Në këtë mënyrë do të mundësohet mbikëqyrje dhe vlerësim i situatave me rastet e dhunës në familje si dhe krijimi i përgjigjeve adekuate.

Themelimi i një sistemi për evidentim dhe njoftim në lidhje me rastet e dhunës në familje nga ana e gjykatave dhe prokurorive publike është realizuar pjesërisht. Gjegjësisht, është themeluar SAKMGJ-Sistem i automatizuar kompjuterik për menaxhim me lëndët gjyqësore. Gjithashtu, në juridiksionin e administratës gjyqësore është: "sigurimi i të dhënave për raporte statistikore dhe pyetësorë statistikor dhe sipas nevojës plotësim i raporteve statistikore dhe pyetësorëve statistikor."

Njëkohësisht, është themeluar edhe një grup i punës për standardizimin e përdorimit dhe përparimit të SAKMGJ nëpër Gjykata, gjë që do t'ju japë informata për atë se a funksionon ky sistem, deri në cilën shkallë funksionon dhe a ofron një bazë solide për regjistrim cilësor të rasteve të dhunës në familje nëpër gjykatat dhe prokuroritë publike.

Qëllimi i posaçëm 8: Themelimi i mekanizmit për zbatimin e Strategjisë

Organi koordinues nacional e koordinon krijimin e politikave dhe zbatimin e Strategjisë nacionale për parandalimin e dhunës në familje dhe strategjive tjera nacionale nëpërmjet organizimit të takimeve të rregullta mujore, ku prezantohen aktivitetet rrjedhimore të të gjitha palëve relevante.

Si një ndër aktivitetet kryesore të këtij organi është miratimi i Protokolit të përbashkët për veprimet e institucioneve kompetente dhe sektorit joqeveritar në rastet e dhunës në familje me mekanizëm përkatës të referimit.

Me qëllim që të përforcohen kapacitetet e Organit koordinues nacional, janë realizuar disa trajnime që anëtarët e këtij organi të njihen dhe për të pasurojnë dituritë e tyre në lidhje me të drejtat themelore të njeriut, qasjet gjinore dhe monitorimin dhe vlerësimin e procesit të ndjekjes së zbatimit të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011.

Pjesa e dytë

Qasje më e madhe në informata është mundësuar me krijimin e ueb faqes për Organin koordinues nacional për dhunë në familje.

2.1. Vizioni

Vizioni i Strategjisë nacionale për mbrojtje dhe parandalim të dhunës në familje 2012-2015 është që deri në fund të vitit 2015 në Republikën e Maqedonisë të arrihet:

- Të kuptuarit e dhunës në familje si shkelje serioze e të drejtave të njeriut dhe të ngritet vetëdija publike për mostolerimin e dhunës në familje;
- Rritje e sigurisë së viktimave;
- Rritje e numrit të aktiviteteve për hetime efikase, ndjekje penale dhe përgjegjësi, si dhe dënim të atyre që ushtrojnë dhunë në familje;
- Rritje të cilësisë së shërbimeve për viktimat dhe standardizim të tyre;
- Njohje e dhunës në familje si dhunë në bazë gjinore;
- Rritje e efektivitetit të sistemit nëpërmjet planifikimit strukturor, monitorimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit të situatave.

2.2. Misioni

Misioni i të gjitha palëve për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje është që me sjelljen e Strategjisë të mundësohet:

- Definim i prioriteteve strategjike për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje;
- Krijim i një kulture gjerësisht të pranuar për njohjen dhe parandalimin e dhunës në familje nëpërmjet rritjes së kuptimit të të drejtave themelore të njeriut;
- Zhvillim i qasjes gjithëpërfshirëse në realizimin e detyrave të parapara me këtë strategji;
- Qëndrueshmëri të rezultateve të arritura me zbatimin e qëllimeve të Strategjisë.

2.3. Karakteristikat kryesore inovative të Strategjisë 2012-2015

Strategjia nacionale për parandalim të dhunës në familje 2012-2015 paraqet një vazhdimësi logjike të përparimit dhe të qëllimeve të arritura të Strategjisë së mëhershme nacionale 2008-2011, por, njëkohësisht krijon:

- Një kornizë të re ligjore dhe institucionale për të gjitha llojet e dhunës në familje dhe kategoritë e viktimave, me theks të veçantë në kategoritë e viktimave më të rrezikuara, e posaçërisht në rrezikun e shumëfishtë si rezultat të moshës (fëmijë dhe persona të moshuar), gjini, invaliditet dhe çfarëdo veti tjetër e cila në kontekstin e Maqedonisë gjeneron rrezikim të shumëfishtë;
- Përsosje të mekanizmave ekzistuese për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe zhvillim dhe plotësim të vazhdueshëm të tyre në përpuethshmëri me standardet më të reja ndërkombëtare dhe rajonale;

- Themelim të një sistemi të përhershëm koordinues nacional për ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të politikave strategjike (Organ i përhershëm koordinues nacional);
- Përmirësim të bashkëpunimit dhe koordinimit mes nivelit qendror dhe aktorëve lokal në parandalimin dhe eliminimin e dhunës në familje;
- Zhvillim të pakove të masave individuale të standardizuara për parandalim dhe ndihmë të viktimave të cilat i adresojnë nevojat e tyre individuale;
- Përmirësim të hetimeve dhe ndjekjeve penale me njohjen e duhur për të drejtat e viktimave dhe trajtimin e tyre në sistemin juridiko-penal;
- Standardizim dhe zgjerim i afrueshmërisë së masave për ndihmë dhe përkrahje të viktimave, si dhe masave për trajtim të dhunuesve;
- Rritje të koordinimit të sistemit juridiko-penal si tërësi dhe të sistemit të mbrojtjes sociale dhe shëndetësore të viktimës, por edhe koordinim dhe plotësim të tyre të ndërsjellë.

2.4. Parimet kryesore

Të gjitha palët relevante për parandalimin e qëllimeve dhe detyrave të Strategjisë nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje i respektojnë dhe i praktikojnë parimet e përgjegjësisë, partneritetit, trajtimit të viktimave sipas të drejtave dhe lirive të njeriut, jodiskriminimit, transparencës, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë.

2.4.1. Përgjegjësi

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, autoritetet lokale dhe shoqëria civile, të gjithë këta janë përgjegjës dhe kompetentë për definimin e qëllimeve dhe detyrave dhe zbatimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Njëkohësisht, Qeveria e RM-së dhe autoritetet lokale janë përgjegjës edhe për sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare për zbatimin e aktiviteteve dhe qëndrueshmërinë e rezultateve.

Qeveria e RM-së, autoritetet lokale dhe shoqëria civile janë të detyruara që të përdorin përkrahje efektive të siguruar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe kapaciteteve nacionale.

2.4.2. Partneritet

Bashkëpunimi i suksesshëm i institucioneve të pushtetit qendror, atij lokal dhe shoqërisë civile, nënkupton edhe partneritet dhe ndarje të aktiviteteve. Institucionet e Qeverisë së RM-së nuk janë kompetente vetëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Zbatimi i qëllimeve strategjike i përfshin të gjitha palët e interesuara, e sidomos theksohet roli i pushtetit lokal në sigurimin e qasjes deri shërbimet për viktimat dhe reintegrim efikas të tyre. Shoqëria civile ka rol vendimtar në ndërtimin e partneritetit me institucionet e sistemit me qëllim që t'u ofrohet ndihmë viktimave, të bëhen hulumtime, analiza dhe promovime të mostolerancës ndaj dhunës në familje.

2.4.3. Të vepruarit me viktimat sipas të drejtave dhe lirive të njeriut

Në të gjitha aktivitetet e parapara në Strategji është prezent parimi i të vepruarit me viktimat në bazë të të drejtave dhe lirive të njeriut. Duke filluar nga obligimi për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përpuethshmëri me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe dokumentet ndërkombtare, fokusi është te përmirësimi i mbrojtjes të së drejtave të viktimave. Para së gjithash, mbrojtje e barabartë për të gjithë, tejkalim i njollosjes dhe integrim i viktimave në shoqëri. Në ndërmarrjen e aktiviteteve, kujdes i veçantë i kushtohet dhunës në familje të bazuar në gjininë e viktimës.

2.4.4. Jodiskriminim

Të gjitha aktivitetet të cilat ndërmerren me qëllim që të realizohen qëllimet e parapara në Strategji njohin lidhjen e ndërsjellë mes diskriminimit dhe dhunës në familje. Njëkohësisht, aktivitetet ndërmerren pa diskriminuar. Është me rëndësi të merret parasysh fakti se diskriminimi

i disa grupeve të caktuara në shoqëri është akoma shumë i përhapur dhe prandaj aktivitetet janë posaçërisht të adresuara kah mbrojtja e viktimave të cilat ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë.

2.4.5. Transparencë

Të gjitha aktivitetet nga të gjitha palët e përfshira të cilat ndërmerren në raport me programe dhe plane për zbatimin e qëllimeve strategjike të Strategjisë janë të hapura dhe të ndara mes palëve. Qeveria dhe autoritetet lokale theks të veçantë i vënë qasjes në informata dhe shpërndarjes së mjeteve, mes tjerash edhe nëpërmjet të shpalljes së rregullt të informatave në ueb faqen e OKN.

2.4.6. Efikasitet dhe qëndrueshmëri

Në ndërtimin e politikave për parandalimin e dhunës në familje, gjëja kryesore është sigurimi i një koordinimi gjithëpërfshirës i aktiviteteve. Përmirësimi i mbrojtjes, gjegjësisht ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve të cilat do të ulin apo eliminojnë faktorët të cilët kanë ndikim negativ ndaj jetës familjare, është një obligim i përbashkët i autoriteteve qendrore dhe atyre lokale. Sistemi i ndjekjes dhe vlerësimit të zbatimit është një detyrë specifike e Qeverisë së RM-së, por, autoritetet lokale do të kenë një rol kyç në krijimin e një sistemi efektiv të monitorimit, nëpërmjet zhvillimit të planeve lokale të veprimit për zbatimin e qëllimeve dhe aktiviteteve të Strategjisë, duke i pasur parasysh nevojat e bashkësisë lokale. Kjo do të sigurojë shpërndarjen e duhur të resurseve financiare dhe njerëzore, të nevojshme për zbatimin e planeve të veprimit pa marr parasysh ndryshimet politike apo ndryshimet tjera shoqërore..

2.5. Rreziqet

Rreziqet të cilat mund të shkaktojnë prolongimin e aktiviteteve të Strategjisë janë:

- Mospërshtatja e aktiviteteve me buxhetet adekuate financiare
- Prolongimi i kornizës së paraparë kohore
- Koordinimi i pamjaftueshëm mes palëve relevante për zbatimin e masave të Strategjisë në kohë. Përmirësimi i bashkëpunimit mes sektorëve dhe i bashkëpunimit ndërministror, bashkëpunimit me sektorin joqeveritar, i bazuar në parimin e transparencës dhe partneritetit; zbatim dhe qëndrueshmëri të sistemit të mbrojtjes nëpërmjet resurseve për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe të Strategjisë për rritjen e nivelit të mbrojtjes dhe ndihmës ndaj familjes në të cilën është prezente dhuna.

Pjesa e tretë – Qëllimet strategjike

3.1. Qëllimi kryesor strategjik

Qëllimi kryesor strategjik i Strategjisë për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015 është:

Avansimi i masave për parandalim, njohja e gjerë dhe përmirësimi i mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje përmes qasjes së koordinuar multi-sektoriale në nivel nacional dhe lokal.

Qëllimi kryesor strategjik zbatohet nëpërmjet pesë sferave strategjike dhe aktiviteteve adekuate, edhe atë: parandalim, mbrojtje, ndihmë dhe përkrahje të viktimave, ndjekje penale të autorëve, bashkëpunim mes më shumë sektorëve dhe ngritjaes së kapaciteteve institucionale dhe shërbimeve të specializuara, si dhe zbatim, monitorim dhe vlerësim.

3.1.1 FUSHA STRATEGJIKE – PARANDALIMI

3.1.1.1. Qëllimi i posaçëm strategjik 1:

Ngritja e vetëdijes dhe të kuptuarit e dhunës në familje si shkelje e rëndë e të drejtave dhe lirive të njeriut

Rezultati:

3.1.1.1.1: Vetëdije publike për zero tolerancë ndaj dhunës në familje

Aktiviteti:

- 3.1.1.1.1: Zbatim të fushatave nacionale dhe lokale
- 3.1.1.1.2: Organizim i tribunave dhe debateve publike, posaçërisht në mjediset rurale duke adresuar të kuptuarit tradicional të roleve gjinore të grupeve të ndryshme etnike

Rezultati:

3.1.1.1.2: Module të zhvilluara dhe të përfshira për sjellje jo të dhunshme në të gjitha nivelet e arsimit

Aktiviteti:

3.1.1.1.3: Përfshirja e moduleve për sjellje pa dhunë në programet mësimore të të gjitha niveleve të arsimit dhe edukimit parashkollor me theks të veçantë në kycjen e djemve dhe burrave në ngritjen e vetëdijes për të gjitha llojet e dhunës, përfshirë këtu edhe rolet tradicionale gjinore

Rezultati:

3.1.1.1.3: Rritje të vetëdijes dhe njohurive profesionale për papranueshmërinë e dhunës në familje, dhunës në familje të bazuar në përkatësi gjinore, si dhe barazi gjinore dhe jodiskriminim.

Aktiviteti:

3.1.1.1.4: Vlerësim dhe zhvillim të programeve strukturore për trajnime të punonjësve profesionalë në mbrojtjen sociale, arsimtarëve, edukatorëve dhe përkëdhelëseve, punonjësve shëndetësorë, policëve, prokurorëve publik dhe gjykatësve, për paragjykime dhe stereotipe, barazi gjinore, dallime kulturore.

Palë të përfshira:

Të gjitha palët relevante, përfshirë këtu edhe sektorin joqeveritar

Afati:I vazhdueshëm

3.1.1.2. Qëllimi i posaçëm strategjik 2:

Sensibilizimi i aktorëve lokal për ndërmarrjen e aktiviteteve për zvogëlimin e rreziqeve për dhunë në familje në bashkësinë lokale

Rezultati:

3.1.1.2.1: Formim i bashkësisë lokale të biznesit për përkrahje në zvogëlimin e rreziqeve për dhunë në familje

Aktiviteti:

3.1.1.2.1: Formimi i bashkësive lokale të biznesit për përkrahjen e programeve dhe strategjive lokale

3.1.1.2.2: Formimi i organeve në kuadër të subjekteve të biznesit për përgjegjësi shoqërore ndaj grupeve të rrezikuara nga dhuna në familje

3.1.1.2.3:Shkëmbim i praktikave të mira dhe përvojave lokale për një shoqëri përgjegjëse të biznesit

Palë të përfshira:

MPPS, MPB, MSH, MASH, komunat, Odat ekonomike rajonale, OJQ

Afati: Deri në fund të vitit 2013

3.1.1.3 Qëllimi i posaçëm strategjik 3:

Formimi i organeve lokale për parandalimin e dhunës në familje në këshillet lokale për parandalim

Rezultati:

3.1.1.3.1: Miratim i programeve lokale të cilat përmbajnë aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës në familje nga ana e komunave

Aktiviteti:

3.1.1.3.1: Përgatitja dhe miratimi i programeve lokale të cilat përmbajnë aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës në familje

Rezultati:

3.1.1.3.2: Formim i ekipeve lokale ndër-sektoriale për intervenim në rast të dhunës në familje dhe miratim i përkrahjes dhe regjistrimit të detyrave të secilin anëtar relevant të ekipeve

Aktiviteti:

3.1.1.3.2: Organizim i mbledhjeve sektoriale të punës me aktorët kompetentë territorial për zhvillimin e mekanizmave për koordinim dhe komunikim në lidhje me aktivitetet e ekipeve lokale ndër-sektoriale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje

3.1.1.3.3: Organizim i mbledhjeve multi sektoriale për sinkronizimin e zhvillimit të mekanizmave për koordinim dhe komunikim në lidhje me aktivitetet e të gjithë aktorëve në ekip

Rezultati:

3.1.1.3.3: : Miratim të Planit vjetor të punës me përkrahje financiare të komunave në kuadër të buxheteve dhe donatorëve të tyre;

Aktiviteti:

3.1.1.3.4: Përfshirje aktive e ekipeve ndër-sektoriale për intervenim në punën e organit të posaçëm për parandalim nga dhuna në familje të formuara në kuadër të këshilleve lokale për parandalim.

Rezultati:

3.1.1.3.4: Përfshirje e punëtorive shëndetësore në të gjitha organet e formuara lokale

Aktiviteti:

3.1.1.3.5: Koordinimi i aktiviteteve mes këshilleve për shëndet publik dhe këshilleve për parandalim

Palë të përfshira:

MPPS, MPB, MSH, MASH, Komunat, Odat ekonomike rajonale, OJQ-të të cilat punojnë në fushën e dhunës në familje

Afati: I vazhdueshëm

3.1.1.4. Qëllimi i posaçëm strategjik 4:

Përforsim i kapaciteteve për zbatimin e aktiviteteve për parandalim

Rezultati:

3.1.1.4.1: Zhvillim dhe miratim i moduleve për trajnime të punonjësve profesionalë në mbrojtjen sociale, arsimtarëve, edukatorëve dhe përkëdhelësve, punonjësve shëndetësorë, policëve, prokurorëve publik dhe gjykatësve, me doracakë adekuatë dhe materiale punonjëse;

Aktiviteti:

3.1.1.4.1: Zhvillim të modulit për parandalim nga dhuna në familje në nivel sektorial

3.1.1.4.2: Zhvillim të modulit për veprim të koordinuar multi-sektorial në parandalimin e dhunës në familje, duke përfshirë këtu edhe sektorin joqeveritar

Rezultati:

3.1.1.4.2: Përforsim i kapaciteteve për zbatimin e aktiviteteve për parandalim në nivel lokal

Aktiviteti:

3.1.1.4.3: Zbatim i trajnimeve të vazhdueshme sektoriale në pajtim me Modulin e përgatitur

3.1.1.4.4: Zbatim i trajnimeve të vazhdueshme multi-sektoriale

3.1.1.4.5: Përsosja e vazhdueshme e kapaciteteve të organeve lokale për parandalim dhe mbrojtje, me qëllim që të mbahet qëndrueshmëria e tyre

3.1.1.4.6: Zbatim i trajnimeve për parandalim të deficitit të profesionistëve të cilët veprojnë në rastet e dhunës në familje

Palë të përfshira:

MPPS, Enti për punë sociale, QPS, Qendra për trajnime e MPB-së, Akademia për gjykatës dhe prokurorë, qendra për shëndet publik, Inspektorati shtetëror sanitar shëndetësor, Oda mjekësore e Maqedonisë, MASH, Enti për zhvillim të arsimit, OJQ të cilat punojnë në fushën e dhunës në familje, odat rajonale ekonomike dhe shoqatat profesionale të aktorëve relevant, OKN.

Afati: I vazhdueshëm

3.1.2. FUSHA STRATEGJIKE –Mbrojtje, ndihmë dhe përkrahje të viktimave

3.1.2.1. Qëllimi i posaçëm strategjik 1:

Avansim i përgjigjes institucionale menjëherë pas dhunës, përmes vendosjes së qasjes holistike

Rezultati:

3.1.2.1.1: Avansim i legjislaturës për mënyrën e trajtimit të viktimave;

Aktiviteti:

3.1.2.1.1: Ndryshim dhe plotësim i lëggjislaturës në përpuethshmëri me standardet ndërkombëtare

Rezultati:

3.1.2.1.2: Trajnues të trajnuar për zbatimin e trajnimeve për personat profesionistë për punë me ushtrues të dhunës në familje;

Aktiviteti:

3.1.2.1.2: Zbatimi i trajnimeve për trajnues

Rezultati:

3.1.2.1.3. Kapacitete të përforcuara të personave profesionistë për punë me autorët e veprave

Aktiviteti:

- 3.1.2.1.3. Trajnime të zbatuara të personave profesionistë për punë me autorët e veprave
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.4: Janë themeluar qendra për këshillim me qasje rajonale për viktimat;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.4: Zgjerim të rrjetit të qendrave për këshillim për trajtim psiko-social të viktimave, përfshirë edhe fëmijët
- 3.1.2.1.5: Identifikim dhe promovim të përgjigjes së duhur institucionale më lidhje me dhunën në familje ndaj viktimave më të ndjeshme
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.5: Qendra të themeluara rajonale për këshillim të prindërve dhe fëmijëve
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.6: Zgjerim të rrjetit të qendrave për këshillim të prindërve dhe fëmijëve
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.6: Qendra të themeluara rajonale për këshillim të ushtruesve të dhunës
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.7: Zgjerim të rrjetit të qendrave për këshillim për trajtim psiko-social të ushtruesve të dhunës në familje
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.7: Implementim të masave aktive për punësim të viktimave;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.8: Përfundim i vazhdueshëm ekonomik i viktimave përmes masave aktive për punësim, bashkë me programet për përkrahje psiko-sociale dhe për ndërtim të karrierës.
- 3.1.2.1.9: Themelim të një sistemi mentor për përkrahje të viktimave të përfshira në programet ekonomike
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.8: Qasje në Qendrën për viktimat të dhunës në familje;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.10: Qasje në rrjet rajonal të strehimoreve (qendra për viktimat të dhunës në familje)
- 3.1.2.1.11: Vazhdim të funksionimit të SOS linjave nacionale dhe një bashkëpunim i koordinuar i SOS linjave lokale, dhe përfundim të kapaciteteve për strehim të viktimave
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.9: Zhvillimi dhe miratimi i një instrumenti për vlerësim të rrezikut nga dhuna në familje;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.12: Zhvillimi i një instrumenti unik për vlerësim të rrezikut nga dhuna në familje
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.10: Zhvillimi i Standardit të shërbimeve që siguron sektori joqeveritar;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.13: Formimi i një grupi punues për zhvillim të Standardit të shërbimeve që siguron sektori joqeveritar;
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.11: Përgatitja dhe distribuimi i broshurave me informata për shërbimet në dispozicion për viktimat dhe të drejtat e tyre;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.14: Përpunimi i broshurave
- 3.1.2.1.15: Promovimi i distribuimit efikas të informatave të kuptueshme deri te viktimat e dhunës në familje dhe përkrahje për sektorin joqeveritar në informimin e viktimave dhe qasje deri te informatat
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.12: Program i zhvilluar i strukturuar për punë me ushtruesit e dhunës në Qendrat për varësi
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.16: Zhvillimi i programit të strukturuar për punë me ushtruesit e dhunës në qendrat ekzistuese për varësi dhe në qendrat e reja për varësi në raste të dhunës në familje, si

- rezultat i keqpërdorimit të mjeteve të ndryshme (alkool, mjete narkotike)
- Rezultati:**
- 3.1.2.1.13: Komunitete rajonale për terapi
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.1.17: Përfshirje aktive në funksionimin e komuniteteve për terapi për risocializim të shfrytëzuesve të drogës dhe alkoolit, që janë ushtrues të dhunës në familje.
- Palë të përfshira:**
- MPPS, MD, MPB, MSH, OJQ
- Afati:**
- I vazhdueshëm
Ueshëm
- 3.1.2.2. Qëllimi i posaçëm strategjik 2:**
- Avansimi i formave për identifikim të të gjitha formave të dhunës në familje dhe identifikim të viktimave
- Rezultati:**
- 3.1.2.2.1: Miratimi dhe testimi i programit për trajnim për mbrojtje nga dhuna në familje dhe definimi i indikatorëve për monitorim të suksesit të trajnimit;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.2.1: Vlerësim i përparimit të programit për trajnim në pjesën për mbrojtje nga dhuna në familje dhe identifikim të viktimave.
- Rezultati:**
- 3.1.2.2.2: Module të zhvilluara dhe të miratuara për trajnim të punonjësve profesionistë në mbrojtjen sociale, mësimdhënës, edukatorë dhe përkëdhelës, punonjës shëndetësor, nëpunës policor, prokurorë publik dhe gjykatës, me doracakë adekuatë dhe materiale pune;
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.2.2: Zhvillimi i modulit për trajnime në sektore për mbrojtje nga dhuna në familje dhe zhvillimi i doracakëve të duhur dhe materialeve për punë
- Rezultati:**
- 3.1.2.2.3: Modul i përgatitur për bashkëpunim mes sektorëve dhe koordinim për mbrojtje nga dhuna në familje.
- Aktiviteti:**
- 3.1.2.2.3: Zhvillimi i modulit për trajnim për bashkëpunim mes sektorëve dhe krordinim të mbrojtjes nga dhuna në familje dhe përpilimi i doracakëve adekuat dhe materialeve për punë
- Rezultati:**
- 3.1.2.2.4: Kapacitete të përforcuara për zbatim të aktiviteteve për mbrojtje në nivel lokal
- Aktivitetet:**
- 3.1.2.2.4: Zbatim të trajnimeve të vazhdueshme nëpër sektore në pajtim me Modulën e përgatitur
- 3.1.2.2.5: Zbatim të trajnimeve të vazhdueshme mes sektorëve
- 3.1.2.2.6: Avansim të vazhdueshëm të kapaciteteve të organeve lokale për parandalim dhe mbrojtje për mirëmbajtje të tyre
- 3.1.2.2.7: Zbatim të trajnimeve për parandalim të fenomenit të deficitit të profesionistëve që punojnë në rastet e dhunës në familje
- Palë të përfshira:**
- MPPS, Enti për veprimtari sociale, QPS, Qendra për trajnim pranë MPB-së, Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve, MSH, qendrat për shëndet publik, Inspektorati shtetëror për sanitari dhe shëndet, Oda e mjekëve të Maqedonisë, MASH, Enti për zhvillim të aesimit, sektori joqeveritar që punon në lëminë e dhunës në familje, dhe shoqatat profesionale të palëve të përfshira relevante, OKN
- Afati:** Deri në fund të vitit 2015

3.1.2.3. Qëllimi i posaçëm strategjik 3:

Qasje në ndihmë dhe mbrojtje direkte të viktimave

Rezultati:

3.1.2.3.1: Vlerësim i zbatuar i shërbimeve për viktimat dhe disponueshmërinë e tyre dhe definimi i propozim masave

Aktivitetet:

3.1.2.3.1: Revidim të shërbimeve për viktimat dhe disponueshmërinë e tyre, përfshirë shërbimet e specializuara për viktimat e dhunës në familje

3.1.2.3.2: Përpilim të propozimeve për përmirësim të shërbimeve për viktimat

Palë të përfshira:

Organi koordinativ nacional

Afati: Deri në fund të vitit 2014

3.1.2.4. Qëllimi i posaçëm strategjik 4:

Integrimi i viktimave në jetën shoqërore

Rezultati:

3.1.2.4.1: Profesionalizëm më i madh te punonjësit profesionistë për përforsim të viktimës

Aktiviteti:

3.1.2.4.1: Edukim i vazhdueshëm i punonjësve profesionistë dhe koordinim mes sektorëve për nxitje të motivimit te viktimat për përfshirje aktive në jetën shoqërore

Rezultati:

3.1.2.4.2: Përfshirje më e gjerë e viktimave të dhunës në familjen në masat aktive për punësim

Aktivitetet:

3.1.2.4.2: Zbatim të trajnimit për mentorë të viktimave të dhunës në familje

3.1.2.4.3: Shpërndarje efikase e informatave për disponueshmërinë e masave aktive për punësimin e viktimave të dhunës në familje

3.1.2.4.4: Sensibilizim i komunitetit lokal dhe të komunitetit të biznesit për ri-integrimin e viktimave të dhunës në familje

3.1.2.4.5: Formimi i grupeve për vetndihmë dhe përkrahje të viktimave të dhunës në familje

Palë të përfshira:

MPPS, MASH, APRM, OJQ, komuniteti i biznesit, komuniteti lokal

Afati: Deri në dhjetor të vitit 2015

3.1.3. FUSHA STRATEGJIKE – Përndjekja e autorëve

3.1.3.1. Qëllimi i posaçëm strategjik 1:

Avansimi i kornizës ligjore dhe normative

Rezultati:

3.1.3.1.1: Ligje nacionale të ndryshuara dhe të plotësuara dhe përmirësimi i evidencave për shqiptimin e masave për siguri dhe lloje të ndryshme për mbikqyrje mbrojtëse të shqiptuara me gjykim fuqplotë ndaj ushtruesit të dhunës në familje;

Aktivitetet:

3.1.3.1.1: Harmonizim i legjislaturës me standardet ndërkombëtare;

Rezultati:

3.1.3.1.2: Viktima të dhunës në familje të përfaqësuara në fondin për dëmshpërblim të viktimave;

Aktivitetet:

3.1.3.1.2: Formim i Grupit të punës për shqyrtimin e nevojave të viktimave të dhunës në familje në Fondin për dëmshpërblim të viktimave

Rezultati:

3.1.3.1.3: Udhëzim i përpiluar për zbatimin e masave për mbrojtje procesuale të viktimave dhe efikasitet i rritur i sistemit të dhënies së ndihmës për mbrojtjen e viktimave të dhunës

në familje

Aktivitetet:

3.1.3.1.3: Zhvillim i mekanizmave për zbatimin e masave për mbrojtje procesuale të viktimave të dhunës në familje dhe qasje deri tek viktimat

Rezultati:

3.1.3.1.4: Efikasitet i rritur i masave të përkohëshme për mbrojtje nga dhuna në familje

Aktivitetet:

3.1.3.1.4 Vlerësim i veprimtarisë së profesionistëve gjatë propozimit, shqiptimit, zbatimit dhe monitorimit të masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje.

3.1.3.1.5: Zhvillim i propozimeve për rritjen e efikasitetit të propozimit, shqiptimit, zbatimit dhe monitorimit të masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje.

3.1.3.1.6: Realizimi i takimeve mes sektorëve me qëllim të ndërtimit të praktikës koordinuese për propozimin, shqiptimin, zbatimin dhe monitorimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje.

3.1.3.1.7: Sigurimi në kohë i dokumentacionit të kompletuar për rastet në QPS, përmes zbatimit të përpiktë të normave ligjore për informimin e QPS për të gjitha aktivitetet e ndërmarra dhe përcjelljen e dokumentacionit nga pjesëmarrësit e angazhuar në rast (sidomos për shkak se edhe vetë viktimat ka të drejtë të paraqesë propozim deri në gjykatë për shqiptimin e masës së parakohshme për mbrojtje)

Palë të përfshira:

MPB, MPPS, MD, MASH dhe OJQ, komuniteti lokal

Afati: I vazhdueshëm

3.1.3.2. Qëllim i posaçëm strategjik 2:

Zbatimi efikas i bazuar në respektimin e të drejtave të viktimave

Rezultati:

3.1.3.2.1: Nën punës policor, prokurorë publik dhe gjykatës të trajnuar dhe të sensibilizuar dhe zvogëlim të viktimizimit dytësor të viktimës dhe grumbullimi i vazhdueshëm i rasteve gjyqësore për dhunë në familje

Aktivitetet:

3.1.3.2.1: Analizë të arsyeve për grumbullim të rasteve gjyqësore për dhunë në familje dhe propozim masa për tejkalim të gjendjes

3.1.3.2.2: Përgatitja e modulit për trajnim për zbatim profesional të intervistave me viktimat dhe për krijimin e procesverbalit audio-vizuel i cili do të përdoret si dëshmi

Rezultati:

3.1.3.2.2: Persona profesionistë të trajnuar dhe të sensibilizuar që punojnë në QPS për përkrahje të viktimave dhe shmangie të viktimizimit dytësor

Aktivitetet:

3.1.3.2.3: Unifikim të veprimtarisë sipas Udhëzimeve metodologjike për zbatim të punës profesionale

Palë të përfshira:

Qendra për trajnim pranë MPB-së, Akademia e gjykatësve, Enti për veprimtari sociale, QPS

Afati: I vazhdueshëm

3.1.4. FUSHA STRATEGJIKE – Bashkëpunim mes sektorëve dhe rritje të kapaciteteve dhe shërbimeve të specializuara

3.1.4.1. Qëllimi i posaçëm strategjik 1:

Avansim i qasjes së integruar që përfshin krijimin dhe zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të koordinuar

Rezultati:

3.1.4.1.1: Ligj i miratuar për parandalim të dhunës në familje

Aktivitetet:

3.1.4.1.1: Formimi i një grupi punues për përgatitjen e propozim tekstit të ligjit

Rezultate: 3.1.4.1.2: Formimi i OKN 3.1.4.1.2: Nominim të përfaqësuesve të përhershëm të palëve të përfshira relevante në OKN Rezultati: 3.1.4.1.3: Avansimi profesional i kapaciteteve të anëtarëve të OKN Aktivitete: 3.1.4.1.3: Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta specifike dhe obligim për trajnim, e posaçërisht për fenomenin e dhunës në familje, trajtimi i viktimave dhe bashkëpunim 3.1.4.1.4.: Përmirësim të transparencës në zbatimin e aktiviteteve Palë të përfshira: MPPS, MPB, MSH, MASH, MD dhe OJQ Afati: Deri në fund të vitit 2013 3.1.5. FUSHA STRATEGJIKE - Implementim, monitorim dhe vlerësim 3.1.5.1. Qëllimi i posaçëm strategjik 1: Formim i sistemit për menaxhim me informatat, monitorim dhe vlerësim Rezultati: 3.1.5.1.1: Softver i instaluar dhe i avansuar për grumbullimin e të dhënave për viktimat e dhunës në familje, duke ndërlidhur të gjitha nivelet dhe me analistë të angazhuar Aktivitete: 3.1.5.1.1: Koordinim nga Organi koordinues nacional në bazë të përhershme 3.1.5.1.2: Vendosje të sistemit të evidentimit unik 3.1.5.1.3: Analizim i vazhdueshëm i dukurisë Rezultati: 3.1.5.1.2.Vendosje e metodologjisë për grumbullimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje nga Enti për statistika; Aktivitete: 3.1.5.1.4: Zhvillim i metodologjisë për mirëmbajtjen e statistikave për viktimat e dhunës në familje Rezultati: 3.1.5.1.3: Të dhëna të grumbulluara dhe të përpunuara për gjendjen e viktimave të dhunës në familje në nivel lokal-Plan akcional i miratuar dhe i zhvilluar në nivel lokal; Raporte vjetore të rregullta për dhunën në familje Aktivitete: 3.1.5.1.5: Vendosja e sistemit për vëzhgim në të gjitha nivelet dhe atë: në komuna, për gjendjen në komunitetin lokal; në secilën ministri/institucion ; dhe në nivel nacional Palë të përfshira: OKN (MPPS,MPB, MD, MASH, MSH, Enti shtetëror i statistikave dhe OJQ) Afati: Deri në fund të vitit 2015 3.1.5.2. Qëllimi i posaçëm strategjik 2: Hulumtime empirike (për njerëzit dhe viktimat) Rezultati: 3.1.5.2.1: Raporti i hulumtimit, për hulumtimin e zbatuar të njerëzve-me rekomandim; Aktivitete: 3.1.5.2.1:Zbatimi i hulumtimit nacional për njerëzit, lidhur me dhunën në familje Rezultati: 3.1.5.2.2: Raport nga hulumtimi i zbatuar i viktimave-me rekomandim Aktivitete: 3.1.5.2.2: Zbatim i hulumtimit nacional për viktimat e dhunës në familje Palë të përfshira:OKN Afati: Deri në fund të vitit 2015	Strategji nacionale për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje (2012-2015) Pjesa e katërt Implikimet financiare Ministria për punë dhe politikë sociale, Ministria për punë të brendshme, Ministria e arsimit dhe shkencës, Ministria e drejtësisë dhe Ministria e shëndetësisë, në planet e tyre akcionale vjetore për zbatimin e Strategjisë do t’i kenë parasysh implikimet fiskale për realizimin e aktiviteteve, për vitin në vijim në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme fiskale, përmes formimit të Organit koordinues nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.
---	--

Aneksi I

Grupi punues për përgatitjen e Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2012-2015

- 1. Ministria për punë dhe politikë sociale
Z-nja Sofija Spasovska
Z-nja Irena Todorovska
Z-nja Lidija Shterjov
- 2. Sekretariati i përgjithshëm
Z-nja Vesna Vasileva
- 3. Sekretariati për çështje evropiane
Z-nja Aleksandra Vukovic
Z-nja Nena Nenovska
- 4. Ministria për punë të brendshme
Z-nja Liljana Jakovçevska
Z-nja Zhaklina Prosaroska
- 5. Ministria e drejtësisë
Z-nja Tanja Kikerekova
Z-nja Marijana Atanasoska
- 6. Ministria e shëndetësisë
D-r Suzana Manevska
Prof. d-r Marija Raleva
- 7. Ministria e arsimit dhe shkencës
z. George Nikollov
Z-nja Nada Stoimenova
- 8. Rrjeti OJQ
Z-nja Mila Carovska
Z-nja Elena Dimushevska
- 9. Programi i përbashkët për organizatat e KB-ve, "Përforcimi i kapaciteteve nacionale për parandalimin e dhunës në familje"
Z-nja Jasmina Trajkovska
z. Nehat Ramadani
Z-nja Jelena Krasic
Z-nja Biljana Nastovska
Z-nja Dimitrinka Jordanova Peshevska
Z-nja Sherife Ismaili Kasapi
Z-nja Makedonka Trajkovska
Z-nja Ivona Paunovic
Z-nja Olimpija Grozdanovska
- 10. Konsulent nacional
Doc d-r Stojanka Mirceva

Aneksi II

Dokumente strategjike

- Plani nacional për akcion për pabarazi gjinore 2007-2012,
- Plani operativ për zbatimin e Planit nacional për akcion për barazi gjinore për vitin 2011,
- Plani akcional nacional për punësim 2009 – 2010,
- Plani operativ për programet aktive dhe masat për punësim për vitin 2011-të,
- Strategjia nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë
- Plani akcional nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë
- Plani akcional për luftë kundër tregtisë me fëmijë
- Strategjia për bashkëpunim mes Qeverisë dhe sektorit civil, 2007-2011
- Protokoli i përbashkët për veprim në rast të dhunës në familje,
- Programi për trajtim të personave të dënuar për delikte seksuale i përgatitur në kuadër të reformës së sistemit penitencijal të R.M-së

Dokumente relevante ndërkombëtare

- 1. Deklarata universale e OKB-së për të drejtat e njeriut (1948);
- 2. Pakti ndërkombëtarë i OKB-së për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (Deklarata universale e OKB-së për të drejtat e njeriut 1996);
- 3. Pakti ndërkombëtar i OKB-së për të drejtat qytetare dhe politike (1996);
- 4. Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave (CEDAË), 1979;
- 5. Rekomandimi gjeneral numër 19-të i Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave (Комитет CEDAË), 1992;
- 6. Protokoli fakultativ kah Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave 1999;
- 7. Deklarata e OKB-së për eliminimin e dhunës ndaj grave (1993);
- 8. Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës (CRC), 1989;
- 9. Protokoli fakultativ kah Konventa për të drejtat e fëmijës që i dedikohet shitjes së fëmijëve, prostitucionit fëmijërorë dhe pornografisë fëmijërore 2000;
- 10. Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me invaliditet, 2006;
- 11. Protokoli fakultativ kah Konventa për të drejtat e personave me invaliditet, 2006;
- 12. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për akcion (1995);
- 13. Qëllimet zhvillimore të mileniumit, Samiti i mileniumit i OKB-së (2000);
- 14. Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore (1950);
- 15. Rekomandimi nr.R (90) 2 i Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për masa sociale në lidhje me dhunën në familje;
- 16. Rekomandimi 1450 (2000) i Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës për dhunë ndaj grave në Evropë;

- 17. Rekomandimi 1582 (2002) i Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës për dhunë ndaj grave në familje;
- 18. Rekomandimi nr. R (2002) 5 i Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e grave nga dhuna;
- 19. Rekomandimi 1681 (2004) i Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës- "Fushata për luftë kundër dhunës ndaj grave në familje në Evropë";
- 20. Rekomandimi 1905 (2010) i Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës për domosdoshmërinë e mbrojtjes së fëmijëve të cilët janë dëshmitarë të dhunës në familje.

Legjislatura nacionale

- 1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.52/91; 1/92; 31/98; 91/2001; 84/2003;107/2005).
- 2. Kodi penal („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.37/1996; 80/1999; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008, 114/2009).
- 3. Ligji për procedurë penale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.15/1997, 44/2002, 74/2004, 83/2008, 67/2009)
- 4. Ligji për procedurë penale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 150/2010)
- 5. Ligji për të drejtat e të miturve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.87/2007, 103/2008; 161/2008 и 145/2010).
- 6. Ligji për familje („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.80/92, 9/96, , 38/04,33/06, 84/2008, 117/2009).
- 7. Ligji për mbrojtjesociale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.79/2009,36/11,51/11).
- 8. Ligji për policinë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 114/2006, 6/2009),
- 9. Ligji për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.66/2006; 134/2007 dhe 117/2008)
- 10. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.50/2010)
- 11. Ligji për ndihmë juridike pa pagesë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 161/2009)
- 12. Ligji për mbrojtje shëndetësore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.43/2012).
- 13. Rregullore për mënyrën e zbatimit dhe përcjelljes së masave të shqiptuara për mbrojtje të familjes dhe personave-viktima të dhunës në familje, të ndërmarra nga Qendra për punë sociale dhe për mënyrën e përcjelljes së masave të përkohshme të shqiptuara nga gjykata (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 103/2007).
- 14. Rregullore për standarde dhe norma për themelimin dhe fillimin e punës së njësive për mbrojtje sociale-Qendra për viktima të dhunës në familje (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 33/2007) .
- 15. Rregullore për norma dhe standarde për hapësirë, pajisje, kuadro profesionalë dhe mjete të nevojshme për themelimin dhe fillimin me punë njësive për mbrojtje sociale-Këshillimore për kryerës të dhunës në familje (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.69/2012).
- 16. Rregullore për zbatimin e punëve policore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.149/2007).

Aneksi III

Struktura dhe detyrat e Organit koordinativ nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje

Me qëllim që të arrihet nivel më i lartë i efikasitetit dhe veprim i përbashkët në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje në Republikën e Maqedonisë, Organi koordinativ nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje do të formohet në bazë të përhershme. Organi koordinativ nacional është përgjegjës për:

- Përcjelljen dhe analizimin e gjendjes lidhur me dhunën në familje
- Koordinimin e aktiviteteve të institucioneve përkatëse
- Vërtetimin e indikatorëve kuantitativ dhe kualitativ, ndaj të cilëve do të përcillet zbatimi i Strategjisë nacionale 2012-2015
- Avancimi i politikave nacionale, zbatimi i tyre dhe përpilimi i Planit akcional për veprim.

Detyra:

- Përpilimi i Planit akcional vjetor për zbatimin e Strategjisë;
- Vendosja e një kornize kohore dhe të institucioneve për realizimin e aktiviteteve
- Përpilimi i një plani për monitorimin e progresit në përputhshmëri me indikatorët
- Vlerësim gjysmëvjeçar i progresit në periudhën e realizimit
- Rregullisht, çdo gjashtë muaj përgatit raport për dinamikën e aktiviteteve të zbatuara
- Bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare
- Planifikim dhe realizim të aktivitete të koordinuara rreth dhunës në familje
- Vendosja e bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale, ndërmerr iniciativa për përf forcimin e vetëqeverisjes lokale dhe vendos organe koordinative lokale për luftë kundër dhunës në familje
- Zhvillon, propozon ligje, akte nënligjore, në formë të propozimeve
- Përgatit propozim-buxhet në nivel vjetor për punën e OKN-së dhe për zbatimin e Strategjisë
- Shqyrton dhe miraton planet akcionale vjetore të secilës ministri

Në kuadër të OKN-së ndihmë teknike dhe përkrahje jep Njësia për kyçje sociale pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale. Anëtarët e OKN janë përfaqësues nga institucionet relevante: MPPS, MPB, MD, MSH,MASH, SÇE, sektori civil dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Në organ do të marrin pjesë anëtarë të përhershëm dhe të përkohshëm. Organi do të ketë mandat të përhershëm, përkatësisht do të ketë status formal dhe legal. Secili nga anëtarët e

